

INTERVISTË ME MAJLINDA SINANI LULAJ

Prishtinë | Data: 19 Mars, 2024

Kohëzgjatja: 103 minuta

Të pranishëm:

- Majlinda Sinani Lulaj (e Intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Majlindë, nëse mundeni me u prezantu, me na tregu diçka për prejardhjen e ju, kujtimet e para?

Majlinda Sinani Lulaj: Unë jom Majlinda Sinani Lulaj, Sinani domethanë është mbiemri i vajzërisë, Lulaj që ia kam shtu këtij mbiemri të vajzërisë në kohën kur kam vu kunorë. Kam lind në Prishtinë faktikisht po aso kohe janë bartë dokumentat domethanë nëpër komunat prej kah kanë qenë familjet edhe ku n'fakt jam rritë. Unë jam rritë dhe jam formu si njeri në Gllogovcin e atëherëshëm në Drenas me të sotmen. Me ni familje me dy prindërit edhe unë si fëmija ma i madh e pastaj edhe pesë fëmi të tjerë pas meje.

Anita Susuri: Si ka ndodhë që keni lindë në Prishtinë?

Majlinda Sinani Lulaj: Në spital (qeshë). Në Drenas nuk janë kry aso kohe procese të lindjes edhe dy fëmijtë e parë kemi lindë mandej janë ofru shërbime të asaj natyre. Fëmijtë tjerë mandej dikush në spital, dikush mbase edhe në shpi. Se ka ardhë mandej ni periudhë ma e vështirë po kjo ka qenë fillimi si të thush, jeta.

Anita Susuri: Çfarë ka qenë rrethi ku jeni rritë? Prindërit për shembull? Vendi? Në çfarë rrethi jeni rritë?

Majlinda Sinani Lulaj: Të dy prindërit e mi kanë pasë si të thush jetat e tyre jo shumë të lehta në fëmënitë e tyre. Baba im është rritë si ni fëmi pa babë si të thush. Katër muajsh ka qenë kur baba i tij ka vdekë dhe në të dy anët edhe kah baba edhe kah nana kanë qenë gratë që kanë luftë ni rol qëndror si me thanë në mbajtjen e familjes dhe të krijimit dhe të formimit të fëmive. Kështu që baba im bashkë me ni vëlla ma të madh, tri vjet ma të madh se baba im kanë qenë dy fëmijtë e asaj martesës.

Në ndërkohë pastaj ato trysnitë e kohës e kanë detyru për një martesë së sërishtme me lokën, si i kom thanë unë, nanës të babit tem. Pastaj ajo ka kriju te ni familje tjetër. Po meqenëse ka qenë në afërsi rrethi ku janë martu, janë rritë bashkarisht si të thush. Nuk është se ka vuajt gjatë kësaj periudhe në kuptimin në mungesën e babës diçka të tillë. Megjithatë nana ka luftë ni rol qenësor në formimin e tyre.

Në anën tjetër ka ana e mamit ka qenë gjyshja e cila ka lujt rol jo thjeshtë në, si të thush, në formimin e fëmive t'vet po mbase edhe n'formimin tim, në radhë të parë si fëmija ma i madh n'familje.

Meqenëse ajo ka jetu te ne, nana e mamit. Duke pasë parasysh që ajo nuk ka pasë djalë, ka pasë katër vajza. Dy prej të cilave ka luftu, nanën tem dhe tezën e vogël, ka luftu m'i shkollu. Mbase najherë tjetër po ai është ni rrëfim i jashtëzakonshëm i ni gruaje e cila ka folë mes burrash për me siguru shkollimin e vajzave të saj. E shkollimi pastaj është zhvillu me peripetitë e veta i nanës tem edhe tezës t'vogël. Të cilat në atë kohë e kanë kry normalen, kanë mrrri me u ba mësuse edhe mandej duke qenë mësuse nana jem në atë periudhë është njoftë me babin tim. I cili ka shku me dhanë vaksina në atë kohë. Për shkak se babi ka qenë në sektorin shëndetësor, si me thanë, ka punu si laborant mjekësor ndërkohë nana mësuse.

Ka shku në atë shkollë me dhanë vaksina edhe aty janë taku dhe ka ndodhë njohja e parë. Mandej nëpërmjet jo vllaznive prej babës që ka pasë nana jem, sepse edhe aty ka pasë një detaj që ndoshta është mirë me thanë. Gjyshja ka qenë e martune në atë familje fillimisht po si nuse dy javëshe ia kanë mbyttë burrin, kujtoj për gjakmarrje. Mandej e kanë rikthi për tjetrin në familje. Kështu osht' zhvillu si me thanë jeta. Përgjatë jetës ajo ka pasë gjashtë fëmi. Të dy djemtë i kanë vdekë. Bile djalit të madh nuk ia ka ditë as varrin. Ka vdekë në spital diku në Pejë. Derisa kjo ka mbrri me vizitu ai ka vdekë e kanë varros. Domethanë ni histori kështu e dhimbshme familjare e cila pastaj si të thush është rrëfy e stërrëfy mrena familjes.

Kjo ana tjetër mandej kur në momentin kur i kanë kry shkollat fillore nana edhe... nana jem n'radhë t'parë, kanë dashtë me martu dhe aty gjyshja ka ndërhy dhe ka kërku me çu n'shkollë, me shkollu. Nana jem vazhdon, përkundër si të thush, pajtueshmërisë brenda familjes vazhdon shkollën dhe bohet mësuse. Fillimisht në fshatin e vet po mandej vazhdon edhe pas martesës në Drenas, Gllogovc aso kohe për gjatë gjithë jetës të vet po them deri në periudhën e luftës.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë edhe për kujtimet e fëmijërisë, çfarë kujtime keni prej asaj periudhe?

Majlinda Sinani Lulaj: Ndëgjo, ka familje shumë të mëdha po kjo familja jem ka qenë, si të thush, as tipike krejt s'mundem m'i thanë. Nana, baba fëmitë. Po fakti se ka qenë gjyshja, gjyshja nga ana, si të thush, nana e mamit, mrena në familje nuk ka qenë shumë e zakonshme për atë kohë. Zakonisht ka ardhë nana e babit në familje po jo nana e mamit. Megjithatë ka ekzistu nifar' si të thush harmonie dhe disponimi i atillë sa kur janë ba dy gjyshet bashkë shpesh herë rrethi i njerëzve me të cilët ke jetu kanë thanë, "Ta ka marrë djalin". Ajo u kthy e ka thanë, "Na i kemi bashkë edhe djalin edhe vajzën".

Domethanë ka qenë ni lloj edukimi i llojit t'vet që noshta m'ka përcjellë gjithë jetën e m'përcjellë edhe sot. Anën tjetër gjyshja në shpi, domethanë, gjyshja nga ana e mamit ka qenë ni rrëfimtare e jashtëzakonshme. Ajo si të thush edhe ka mbajtë mend shumë po edhe rrëfimet në mënyrën se si i ka ofru ka qenë diçka që kanë lanë gjurmë të pashlyeshme n'mu. Ajo ka pasë një familje nga ana e babës

t'vet që kanë qenë goxha shumë, si të thush, ma të përparun edhe në kuptimin e shkollimit po edhe në kuptimin edhe të guximit. Ajo ka majtë mend edhe rrëfimet e një pas njëshme që edhe të kohës kur kanë luftu ndoshta në kohën e Azem Bejtës e tutje.

Ato rrëfime mandej kanë lanë gjurmë, e kanë lanë gjurmën e vet. Në anën tjetër, ajo ka qenë fëmija ma i madh i babës t'vet dhe nifar' mënyre ka pasë nifar' respekti sepse baba i saj paska qenë ni lloj pleqnari në atë kohë që ka shku odave ose, ku di unë, në rrethanat e asaj kohe ku ka jetu. E si të thush ka gëzu respektin e miqësive rrotull ku ata kanë jetu dhe gjithë ato vizita që janë bo në respekt edhe të babës edhe të gjyshes tem si ni pijë fisi kanë ardhë në familjen tonë.

Unë si fëmi e kujtoj vetën që ulesha jo në si të thush tipike si ni vajzë ndoshta me vu kafen por ulesha kambkryq para tyre dhe ju ofrojshja ni cigare ose ni diçka të tillë. I ngojsha pleqt me mustaqe kur folshin dhe rrëfejshin me gjyshen tem ato gjana që i kanë taku t'kaluarës. Besoj që kjo pjesë ka lanë do gjurmë të pashlyeshme në jetën tem. Ndoshta që sot kur merrna me gjana të vogla arti ose shkrimesh e shoh që gjej mënyrë me u shfaqë në mënyrën qysh unë ose rrëfej ose shkruj. Kjo është ni periudhë.

Mandej ana tjetër që e përmenda, domethanë, thjeshtë prindërit e mi dhe ne si fëmi... të dy prindërit kanë punu asokohe. Ni periudhë nuk ka qenë edhe shumë keq aspekti ekonomik sepse dy prind me dy rroga kanë mujtë me ofru kushte të mira për fëmijtë. Mirëpo në ndërkohë kanë ardhë pas vitit '81 e tutje kanë ardhë gjanat t'u u vështirësu. Derisa ka ardhë periudha kur, si të thush, ka qenë shumë e vështirë për secilin në Kosovë, edhe për familjen time. Krejt ni lloj. Megjithatë mrena familjes domethanë ne kemi vazhdu me funksionu me atë rrethin e vogël tonin me të cilin menoj që si prind na kanë ofru ato parimet e drejtat të të qenit njerit. Me rujtë dinjitetin me pasë ni lloj vertikali në jetë t'cilin kujtoj e kam rujtë gjithë jetës.

Anita Susuri: E në familje ju sa fëmi keni qenë?

Majlinda Sinani Lulaj: Gjashtë.

Anita Susuri: Gjashtë.

Majlinda Sinani Lulaj: Gjashtë. Vajzë, djalë, vajzë, djalë, vajzë, djalë.

Anita Susuri: Ju ma e madhja keni qenë?

Majlinda Sinani Lulaj: Unë ma e madhja, po. Bile edhe prej krahut të axhallarëve kom qenë fëmija ma i madh. Domethanë pas meje pastaj të tjerët.

Anita Susuri: Domethanë familja e madhe, si ka qenë me u rritë me gjithë ata...

Majlinda Sinani Lulaj: Ndëgjo, unë, ndoshta pse prindët e mi kanë qenë të shkollum aq sa kanë pasë... nana ta zamë pas martesës duke m'pasë mu edhe duke qenë shtatzanë me vëllaun ka përfunduar akademinë për cikël klasor që atëherë ka zgjatë tre vjet, nëse nuk gabo. Ka qenë shkollë në Mitrovicë. Domethanë t'u qenë dy prind të shkollun që kishin pa pak ma shumë se noshta të tjerët përreth tyre ose brezat t'më hershëm, unë gjithë jetën i kom pasë prindët shokë. Ndoshta kjo m'ka ndihmu me qenë goxha favor në mënyrën qysh unë kom funksionu n'jetë. Ndoshta shpesh herë kokë në veti. Shpesh herë vendimet që janë sillë rreth meje e kom marrë guximin mos me qëndru brenda kornizash. Kujtoj kjo ka ndiku në formimin tem.

Mirëpo në anën tjetër na i kena pa edhe, si t'thush, ti e merr modelin e prindërve. Një babë i cili ka punu, muj me përmend që ka qenë laborant mjekësor e në atë kohë na kemi pasë banesën, shpijen ku kemi jetu buzë rrugës. Shpesh njerëzit në mungesë të shërbimeve shëndetësore në orët e vona të natës kur kanë pasë nevojë për fëmi të vegjël ose për pleq, ndoshta edhe në momentet e fundit të vdekjes nuk kanë ardhë te shpija me trokit kah dera, kanë trokit te dritarja. Me e thirrë me shku me i dhanë infuzione ose me shku me i dhanë gjilpana. Na gjithë jetën jemi rritë me këtë frymën që ti duhesh me ndihmu tjetrin, duhesh me ia zgjatë dorën tjetrit. Kjo prej anës të babës.

Në anën tjetër ni nanë e cila si ni normaliste sikur shumë normalistë në këtë vend që kanë pasë nifar' lloj disipline të punës të çuditshme po edhe nifar' motivi brenda vetëvetës edhe inkurajimi për punën. E kujtoj nanën tem ni periudhë goxha të hershme të punës t'vet që kur shkonte m'i dhanë mësim fëmive, se e msonte ciklin klasor domethanë prej klasës të parë deri n'klasën e katërt aso kohe, asniherë nuk është nisë pa bo ato përgaditjet e nevojshme. Qoftë me nxjerrë ato notat muzikore për landën e muzikës me ni mandolinë të vogël që aso kohe e kishin. Ose m'u ulë e m'i përgadit poezitë që kish me ju thanë në shkollë ose mësimet që kish me shpjegu atje.

Krejt kjo ka ndiku ndoshta edhe në anën e asaj pjesës që është disiplinë e punës edhe disiplinë në jetë. Që duhet me u formu edhe m'u kriju si njeri. Po n'anën tjetër edhe ajo pjesa që po them jo thjeshtë humane. Kaniherë mendoj që ka qenë shumë e guximshme. Periudha të caktune të jetës e mbaj mend babën tem në kohën e helmimeve për shembull të fëmive në Kosovë, ndër t'parët ka shku diku fillimisht në Podujevë, në shkollat e Podujevës ishin shfaqë raste të helmimeve. Prej Gllogovcit, prej Drenasit të tashëm ka shku ndër të parët atje. Ose aktivizmi i tij për ni kohë t'gjatë në shoqatën Nanë Tereza. Domethanë krejt ajo periudhë natyrisht që ti kur i sheh prindërit në çfarë drejtimi janë dhe çka ofrojnë patjetër që ti formohesh edhe i merr model dhe i ke model në jetën tane.

Anita Susuri: Shkollën fillore e keni kry në...

Majlinda Sinani Lulaj: Edhe shkollën fillore edhe shkollën e mesme. Shkollën fillore e kom kry aty afër. Gllogovci është ni vend i vogël, Drenasi sot. Pastaj kom vazhdu në Gjimnazin e Drenasit edhe sot e kësaj dite është, Gjimnazi "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu", ju bo emri në ato vite sa ishim ne. Unë i kom taku atyne gjeneratave, kanë qenë nja dy gjenerata që ju thojshin, si të thush, gjimnaz ma special

diçka. Që na shtun numrin e landëve. Kam qenë drejtim matematikor, natyror. Nxanëse e mirë (qeshë) gjatë gjithë kohës, po që jo gjithmonë e koncentruar vetëm te msimi.

Kam qenë fëmi goxha kureshtar. Fëmi po them se domethanë krejt ajo periudha ndoshta goxha intensive kështu e aktivitetit tem ka fillu qysh n'fillore po mandej ka vazhdu edhe n'shkollën e mesme. Ka qenë periudhë shumë e veçantë periudha e vitit, fillimisht viti i parë kur ishte periudha e Grevave të Minatorëve kur ne organizoheshim si nxanës, aq sa kemi ditë. Drenasi kishte karakteristikat e veta. Ne ishim ni aktivitet, si të thush, ni komunë etnikisht e pastërt. Na kemi qenë të gjithë shqiptarë. Nuk është se e kemi ni shumë atë trysnin prej dikujt tjetër në atë moment. Po ti e ke ndi atmosferën e përgjithshme.

Mandej mas kësaj periudhe vjen ni moment tjetër diku kah viti i tretë i shkollës të mesme, i dyti dhe i treti në fakt. Kur filluan... u lirojshin ish të burgosurit, domethanë, të burgosurit politik dhe fillun me ardhë dhe më ofru mësimdhanje si profesor mrena, mrena asaj shkolle. Ka qenë Jakup Krasniqi në atë kohë që ka ardhë pak a shumë. Se me vite muj mos me precizu saktë. Ismail Sylja, këta kanë qenë njerëzit me Ismailin. Pastaj profesori Smajl që i thom unë.

Kemi vazhdu për dy-tre vjet rresht dhe kemi vazhdu me mbajtë kontakte me profesorin me përgadit programe të ndryshme. Ai i bonte të gatshme domethanë ato recitale, ato përzgjedhje të poezive, atë linjën, si të thush, frymën që ishte e nevojshme me e përqu. Ne ishim ni grup katër-pesë nxanës që e ndiqnim besnikërisht në atë që na edhe ofrohej po ndoshta e përqafonim se donim me vazhdu si të tillë. Gjindeshim domethanë... fakti që kishte mungesë t'jetës kulturore, fakti që kishte mungesë të televizionit, kishte mungesë t'mediave. Ato pak programe që mbaheshin në shkollla shpesh herë shërbenin me u transmetu edhe me u shfaq edhe nëpër vende tjera dhe në data të caktune.

Fotot që i pam bashkë ju mujtët me pa momente, ta zamë, kur u shënu 28 nëntori '90, sa ishte? '96-ta. Kemi shku prej Drenasit në Komoran. Një sallë e vogël... në fakt as s'ishte në sallë e kulturës, ishte shkollë. Prej aty mandej në ni mbledhi t'vogël sa me çu nga një gotë që thuhet sa për me uru e me bo gëzuar 28 Nëntorin. E kujtoj që n'momentin kur, thuajse ishte t'u u përmbyll, kishte ni moment kur kishin vrejtë dritat. Erdhën me ato kompanjolla a çka ishin ato mjetet e tyne. E kujtoj ishin nisë tre-katër nxanës që kishin me u nisë për Drenas, ishte si të thush distancë e shkurtë shtatë-tetë kilometra prej Komoranit për Drenas po kishte... s'kishte me çka me udhëtu.

E kujtoj që në momentin kur kanë kalu ato kemi trokit me ni shpi afër udhëkryqit aty. Shala mbiemrin nëse nuk gaboj e kanë ajo familje. Na kanë hap derën. Na kanë pa t'ri, kanë vërejtë veturat e policisë na hapën derën. Nuk e harroj momentin kur jemi fut brenda dhe i kemi gjetë po ashtu në familje t'u e festu 28 Nëntorin. Ka qenë moment emocional po edhe ni moment shprese edhe pse ne ishim t'ri po që e shifsh se kjo s'po ndodhë vetëm në ato ambientet publike po po ndodhë në ato qelizat e vogla brenda familjeve. Ai momenti i vogli ku ti shënjon se je diçka ndryshe prej të tjerëve.

Anita Susuri: Po du pak m'u kthy se m'tregut për '89-ten, Grevën e Minatorëve. Po gjithashtu viti '90 është kur janë largu shqiptartë prej institucioneve, kur i kanë largu sigurisht edhe prindërit e juaj kanë mbetë qat' kohë pa punë...

Majlinda Sinani Lulaj: Jo, sepse thashë edhe niherë Gllogovci i asaj kohe ka pasë ni karakteristikë tjetër. Kanë mbetë nëpunë shkolla, dihet, domethanë shkolla si gjithkush po në krejt sektorët e tjerë kanë vazhdu me funksionu sepse s'kanë pasë ku me marrë të tjerë. Ata kanë qenë domethanë dhe ata kanë vazhdu derisa ni periudhë shumë ma t'vonshme kanë çu masa të dhunshme po prapë prej atyne njerëzve aty kanë improvizu. Masa të dhunshme me tendencën me përqa, e gjana tjera po nuk është se ka... edhe pse nuk ishte gjithmonë kjo pjesa e largimit prej punës, ishte edhe tjetra. Ishte devalvimi financiar, inflacioni, ku di unë çka që e vështirësonte edhe nga ky aspekt jetën.

Ata njerëz, ata pak që punoni, kudo që punonin se nuk ishte që gjithmonë njerëzit kanë punu në sektorin publik. Edhe ata njerëz domethanë derisa ktheheshin prej punës në shpi ajo rroga që do duhej me shërby për jetën ose për ushqimin brenda ni muji ndoshta, shndërrohej ni ngjyrë të këpucave ose ni bukë. Domethanë kjo ishte gjendja. Nuk ishte nganjëherë... kur e bisedojmë në familje qoftë me nanën qoftë me babën ose me të tjerët po edhe me të tjerët të brezit. Ti nalesh e kujton dhe thu qysh ke mbijetu, qysh kemi mbijetu, kah, si janë gjetë? Sot që jam prind vet shpesh e mendoj e thom qysh kanë mujtë?

Gjashtë fëmi s'kanë qenë pak. Nuk kemi pasë burim tjetër financiar. Na nuk kemi pasë njerëz jashtë vendit. Domethanë ti je dashtë me mbijetu me ato pak mundësi që i ke pasë. Nuk ka qenë jetë, nuk ka qenë jetë e lehtë për kërkond, as për neve natyrisht.

Anita Susuri: Du me folë pak ma shumë për këto ngjarjet kulturore që jeni aktivizu ma shumë, për shfaqjet e ndryshme që keni organizu. Si ka shku krejt kjo? Kush i ka organizu? Si keni mujtë në ato kushte?

Majlinda Sinani Lulaj: Dëgjo, fakti se kishte nifar' lloj suprimimi jo thjeshtë të instancave ma t'larta po në përgjithësi t'jetës të asaj çka ishte shqiptare në Kosovë, i shtynte njerëzit me u vet organizu. Me gjetë mënyra qysh ti munësh me rujtë diçka që osht' thelbësore. Nëse jo për kush e di çka, për shpirtin e njeriut. Në aso rrethana jemi organizu kështu edhe grupe t'vogla njerëzish që kemi pasë pak ma shumë vullnet. Besa edhe që kemi qenë ma afër qendrës. Që kemi mujtë ma lehtë me mbrri qoftë ni ushtrim... se mund t'ketë pasë njerëz që kanë dashtë me bo atë pjesë t'punës po ndoshta në mungesë edhe të si me ardhë deri te ajo pjesë ku ka qenë ni sallë ose diçka e kanë pasë t'pamundun me u angazhu.

Shpesh herë ushtrimet tona ose takimet tona u dashtë m'i përshtat me oraret e atyne që vinin prej fshatrave. Diku në vitin '90 ndoshta '91, '92 jemi organizu si ni teatër i vogël amator. Nëpërmjet tij pastaj kemi organizu shfaqje të ndryshme. Po kjo ka qenë njana anë. Kjo pjesa e teatrit ka qenë diçka e

organizune n'kuadër të teatrit. Po në të njëjtën kohë kom qenë vazhdueshëm, e përmenda profesorin Ismail, vazhdueshëm me grupin, si të thush, me ata pak nxansa sa ishin, se disa droheshin, nuk ishin gjithmonë të njëjtit se dikush lëvizte prej aty, dikush kishte obligime tjera. Besa fillun me studiu ni pjesë e tyne. Unë isha standard mirëpo të tjerët kanë lëvizë.

Përgjatë gjithë kësaj kohe mandej edhe si vetëm, jo vetëm si grup, po kom, kudo që m'kanë thirrë nifar' mënyre që e kanë pasë t'nevojshme me... shpesh herë ndoshta edhe t'u ecë në kamë me orë të tana për me mbri me ni fshat ku hapej ni grimë shkollë ose ni klasë ose diçka e tillë ose kishte ni ditë të shkollës ose kishte ni moment kur dojshin me shënu diçka. Kjo ka vazhdu për gjatë katër-pesë vjetëve. Duheni me pasë parasysh domethanë unë jom moshë në atë periudhë isha në moshë goxha e re. Domethanë ky aktiviteti i recitimeve kishte fillu ndoshta klasën e tetë. Mirëpo ishte intensifiku në moshën 17-18 vjeçare dhe mandej kishte vazhdu edhe në periudhën e studimeve duke u nda mes Drenasit edhe Prishtinës.

Unë gjithë kohën sa kam qenë aktive në Drenas kam qenë aktive në Prishtinë. Vetëm e kom... si të thush e kom balancu nëse kam mbri kohën. Po ka qenë kohë shumë intensive. Kaniherë kur e kujtoj domethanë qysh ka kalu ni ditë e imja, ndoshta i kom bo katër orë gjum po pjesa tjetër ka qenë prej ni pune në punën tjetër. Për mos me haru me përmend edhe ni detaj që kur i kisha mbush 20, 21 vjet domethanë diku '95-ten, '94-ten unë kisha fillu me punu, me dhanë mësim. Domethanë 20 vjeçare, as 21 nuk i kisha mbushë.

Isha e pa diplomume ende po ishte koha kur arsimi nuk paguhej, nuk paguhej as nana ime. Merrshin ni rrogë diku mbas gjashtë mujve, ni mini rrogë me atë 3 përqind që mbliidhej dhe paguheshin mësusët. Në mungesë të mësusëve po edhe nevojës financiare domethanë, financiare të angazhimit thjeshtë, u... se jo që mora rrogë. Mora mbasi unë veç u largova si të thush prej asaj pune. Ka qenë kjo periudhë domethanë që vërtetë edhe ka qenë intensive po edhe ka qenë periudha kur unë e kom peshu vlerën tem edhe si njeri edhe mbase profesionalisht edhe si dikush që muj me dhanë, muj me ofru.

Anita Susuri: Po koncentrohna te këto ngjarjet...

Majlinda Sinani Lulaj: Po, po.

Anita Susuri: Ku i keni mbajtë për shembull? A keni pasë vende të caktune ku keni mujtë me bo ushtrime ose ku keni mujtë me bisedu, me vendosë çka po doni me bo, me punu?

Majlinda Sinani Lulaj: Prapë karakteristika e Drenasit, fakti se ishin shkollat vazhdojshin me funksionu. Unë për shembull vetëm vitin e katërt e kom mbajtë në punkt. Po pjesën tjetër na kemi funksionu nëpër shkolla, sa kam qenë në shkollë të mesme dhe shkollën fillore. Na kryesisht ushtrimet i kemi mbajtë te shkolla fillore në Drenas, ushtrimet është fjala. Mirëpo kur vinte puna m'i dhanë shfaqjet pastaj e kemi pasë... periudhën kur ka qenë "Toka e Ndezur", ni shfaqje që e kemi dhanë

përgjatë dy-tri viteve, ajo periudhë ka qenë goxha e vështirë. Ka qenë periudha e viteve '90-'91, '92 aty dikund, besa '93. Jo '90, '91, '92, '93 kështu diçka.

Atë periudhë ka qenë ma e vështirë me shku... edhe për shkak të natyrës të shfaqjes. Nuk është se e kemi dhanë në sallë të kulturës sepse ka qenë ni shfaqje që nifar' mënyre ka qenë e papranueshme për regjimin e aso kohe. Mirëpo i kemi dhanë nëpër, kështu, salla, nëpër shkolla që improvizoheshin. Në sallë të edukatës fizike nëse kishte. Ishin salla pak ma masive nëse muj me thanë, ose ta zamë, kur ftoheshim nëpër fshatra, gjithandej nëpër Kosovë jo thjeshtë në Drenas.

Ka ndodhë me shfaqë edhe nëpër ato rimorkio traktora që kishin vendosë, e kishin improvizu nëpër oborre shkolla për shfaqjet e tyre dhe që i shfrytëzonim na. Ose nëpër koridore shkollash aty ku ishin ma të gjata ku vendoseshin banka dhe mbi banka, si të thush, zhvillohej loja e neve aktorëve, kurse pjesa tjetër ishin vendosë ulëse ose karriga ose banka ose edhe në kamë. Fëmi, mësus besa edhe fshatar shpesh herë që vishin shpijave rrotull me pa ni shfaqje shqip.

Ka qenë periudhë, se tash kur po rrëfej këta, po më kujtohet ni periudhë ma e hershme e fëminisë teme. Kur baba jem, në mungesë prapë edhe pse ishte Radio Televizioni i Prishtinës, nuk kishte shumë çka që të ofronte televizioni. M'kujtohet të dielave zakonisht ishte paraditja... se në Drenas nuk është se kemi mujtë me pa televizionin e Shqipnisë. Mirëpo e dielja paradite kur njëri kanal i Beogradit atëherë që s'kishte paradite televizion me do trika të vogël që i bojshin me letra çokollate ose me folie alumini diçka e tillë, i mbështjellshin ato antenat, çka e mbaj mend babën tem.

Bante diçka të tillë edhe në kulmin e shpisë ni antenë në mënyrë që paradite fëmitë me mrrri me pa një film të Kino Studio Shqipëria e Re ose ni shfaqje me kukulla po ashtu të Radio Televizionit të Shqipnisë. Deri në momentin kur fillonte transmetimi i televizionit të Beogradit. Aty ndërprehej. Aty ndërprehej mirëpo e prisnim të dielën sikur me qenë diçka e jashtëzakonshme. Për atë kohë ndoshta sikur me shku kumeditë ku. Domethanë me pa diçka shqip. Pastaj kjo ka vazhdu ma tutje. Bllokimi... mandej u hoq komplet, u pamundësu puna e Televizionit të Prishtinës. S'kishte ma asnjë tjetër.

Këto shfaqje që kemi dhanë, këto... prej perspektivës së sotme duken gjana të vogla po në atë kohë ishte krejt çka kemi mujtë me ba. Nuk ke pasë alternativë tjetër. Nuk ke pasë rrugë tjetër. Krejt këto gjana të vogla e kanë bo qat' qëndresën e përbashkët kolektive të cilës sot i referohemi si e tillë. Mos me pasë qenë këto mendoj që kish qenë shumë e vështirë, shumë e vështirë. S'kemi qenë të vetmit. Ne kemi qenë ni grup se Gllgovci, Drenasi atëherë ka qenë vend i vogël e nuk është se edhe ke mujtë edhe shumë çka me bo. Po këto sa kanë qenë mendoj që edhe ndoshta sot nuk ka ni jetë aktive kulturore qysh e kemi organizu aso kohe.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Ju thatë që keni lëvizë edhe në Prishtinë edhe në Drenas në atë kohë, sa ka qenë e vështirë lëvizja? A keni pa ndoshta diçka prej skenës apo...

Majlinda Sinani Lulaj: Kanë qenë dy, dy jetë goxha t'ndane si me thanë. Tash prap kur po më parashtron pytjen po rikthehem mbrapsht edhe niherë. Brezi im, domethanë, koha kur unë kam fillu shkollën ka qenë periudha '80-'81. E kom fillu shkollën me demonstratat e '81-shes. E kom përmbyllë shkollën fillore në '88 domethanë dhe e kam fillu shkollën e mesme në '89-ten. Në atë periudhën goxha, jo goxha po ekstremisht të vështirë për Kosovën. E kom përmbyllë në '92-ten shkollën e mesme, në ni periudhë sërish sa të vështirë po edhe me ca elemente që në nifar' mënyre kanë inkurajju pastaj lëvizjet e mavonshme.

Në '92 në tetor i kom fillu studimet me protestë. E mbaj mend vetën në... e kam gjetë vetën. Unë kisha ardhë për periudhën, domethanë, kishim ardhë disa ditë sa ishte jo regjistrimi e ato pjesa fillestare. Komplet fakultetet ma nuk funksiononin nëpër objekte. Unë kom fillu dhe i kom mbaru studimet nëpër objekte private. Asnjëherë kama ime s'ka shkelë në Fakultetin Filologjik edhe pse e kom përfundu Fakultetin Filologjik. Në atë periudhë, në atë ditë, domethanë, a ka qenë 12 ose diçka e tillë tetor nuk e kujtoj datën saktë po ka qenë tetori domethanë sa kishin fillu studimet.

E gjej vetën në mesin e demonstratës në Fakultetin Filologjik. E cila pastaj u shtri edhe në shesh. Nuk e di kush e kishte thirrë, nuk e di kush e kishte organizu. Sa kisha ardhë në Prishtinë, nuk e njihja qytetin. E kujtoj që kur intervenoj policia... isha edhe vetëm, nuk kisha prej anës time. Ka qenë ni shoqe që u regjistru në anglisht dhe ishte ni djalë tjetër, ni Fatmiri që ishte në gjuhë dhe letërsi shqipe që ma vonë i ndërpreu studimet. Ma vonë kur na kanë shpërnda, janë fut mes turmës na kanë shpërnda kemi fillu me ikë, me u largu secili prej nesh.

E kujtoj vetën ni moment, diku këtu duhet t'ketë qenë te konviktet, pjesa kur m'janë sul nga tre-katër policë t'u m'njekë. Nuk e di si e kom kalu ni tel si rrethojë, punë rrethoje dhe kam dalë në anën tjetër me ni pus kështu me baltë. Njana kamë në baltë tjetra shpëtoj edhe ju shmanga, si të thush, kapjes të tyne. Sepse ata ishin t'veshun me ato pajisjet e tyne ma t'rana dhe nuk m'rrijsin me më zanë në shpejtësinë teme.

U drejtova me shku në stacionin e autobusave. As nuk e disha qytetin se kisha idenë, e dijsa veç si krah ku është stacioni i autobusave po s'e kisha idenë kah duhet me shku, kisha mbetë vetëm. Edhe ashtu isha thuja vetëm prej anës, nuk njifja dikë në Prishtinë. S'kisha të afërm në Prishtinë. Nuk kisha ni adresë ku muj me u drejtu edhe me gjetë si të thush strehë. E kujtoj, nashta osht' interesant me përmend ni moment, mbërrij në stacion të autobusave disi, rrotull rrotull ashtu.

Mbasi jom fut në autobus e kujtoj që u zhvillu nifar' panike mes njerëzve t'u thanë se kanë ardhë patrullat e policisë dhe janë t'u i kërku ata që i kanë kamtë me baltë. T'u e ditë që kanë vazhdu. Fatmirësisht autobusi u nis pa mri te autobusi ku isha unë, ato kontrollat. Po ai ka qenë ni moment

delikat që e kujtoj në kujtesën time. Mandej periudha e studimeve. Ju pytët për aktivitetin kulturor, po e vazhdoj domethanë në këtë vazhdë.

Viti i parë ka qenë pak a shumë kështu, nuk është se njihja shumë njerëz. Vija shumë herët në Prishtinë. Në fillim udhëtoja me autobus por pastaj kishte ni periudhë kur Jugosllavia e asokohshme, Serbia, kishin masa të atilla që mbetën pa derivate. Domethanë ju vunë sanksione të atilla që s'kishin derivate edhe autobusat edhe mjetet e transportit nuk mbrinin me funksionu. E vetmja mënyrë e ardhjes për studime në Prishtinë, ato ni ditë kur mbanim ligjerata, ishte me tren.

Me tren deri në Fushë Kosovë. Vinte treni i Pejës ose i Prizrenit nëpër Drenas ka kalu. Unë e kom pasë afër shpisë. Shumë herët, diku 05:30 në mëngjes ose në 05:00, nuk e kujtoj orarin saktë. Bile e mbaj mend, baba jem dilte me m'përcjellë se ishte shumë herët, ishte natë. 18 vjeçare kur kisha ardhë si studente. Vijsha deri në Fushë Kosovë. Sa merrsha ni autobus urban nëse kishte, kur kishte, se kishte hera kur kishim ecë prej Fushë Kosovës e deri ku vinim në Prishtinë në kambë.

Me atë autobus po shpesh herë ligjeratat m'fillonin në ora 10:00. Ndodhte që me u ndalë në Ulpianë, në Lakrishte në mënyrë që me shpenzu kohën t'u ecë deri ku i mbanim ligjeratat ato kohe te ni mbahej Nazmi Gafurri, pjesa afër Kodrës së Trimave. Xhemail Ibish, Rruga Xhemail Ibishi aso kohe. Ky viti i parë domethanë pak a shumë ishte kështu me shumë peripeti edhe t'rrugës edhe t'kushteve financiare. S'kishim. Ato para që i kisha i kisha thjeshtë për atë biletë treni ose autobusi me çkado që vija. Po as për ushqim, as për ni ujë as për asni gja.

Nëse nisesha në 05:30 në mëngjes dhe kthehesha diku në ora, nëse nxija trenin në ora 03:00-04:00 kështu sa ishte, mbërrija në ora 05:00 mbas dite në shpi. Ose nëse jo, atëherë mbërrija domethanë, sa i binte, 07:30 ose sa mbrinte treni tjetër. Pra, gjithë dita ishte nëse gjeja dikund një çezmë me pi ujë. Përndryshe ushqim harroje gjithë ditën se nuk kisha, thjeshtë nuk kisha. Ajo periudhë kur mbërrija herët në shkollën ku mbanim ligjeratat ka qenë ni periudhë shumë interesante që nashta m'ka mundësu qato dy-tre orë sa i kryjsha ligjeratat m'ka mundësu me vu kontakt me ata pak studentë që ishim aty.

Radiatorët ishin të ftohtë se s'kishte nxemje. Dimrave ishte ftohtë, nuk ishin dimrat si tash. E kujtoj vetën që shpesh herë ato farmkerat që kisha veshë ose pantollët që kisha veshë shkriheshin në atë periudhë sa rrija dy tre orë, n'trupin tem, sa rrija në ato koridoret e shkollës. Aty e kom taku Nait Hasanin për herë t'parë, në ato periudha në ato dy-tre orësh. Jo se çka kemi bisedu n'atë kohë po së paku jemi identifiku si persona që nashta një kohë ma vonë mandej kemi rujtë disa kontakte dhe kemi pasë edhe biseda që nashta na kanë ndihmu, veçmas mu se ai kishte ni përvojë dhe një jetë, si të thush, kishte çka me mësu tjetrin dhe çka m'i thanë.

Viti i parë ka shku kështu. Jam njoftë me shoqen time, njënen shoqe se dy shoqe t'ngushta kisha këtu mandej. Shoqen time Hyrije Veliu shpijen e së cilës mandej kom gjetë shpesh herë një shtrat me fjetë,

nji tryezë me hangër kur unë kam mbetë ose s'ka pasë mjet udhëtimi m'u kthy në shpi ose kur unë s'kam banu në Prishtinë. Aty kom nejt, te axha Sheqë edhe te nana Sabile shpesh herë, shpesh herë. Aty kanë qenë momentet e para edhe me të kur jemi ofru rreth poezisë, atyne gjanave që na interesojshin.

Mandej në vitin e dytë kom, kam vendosë... realisht e bisedum në shpi dhe vinte edhe motra tjetër e imja, jo si studente po si nxanëse në Prishtinë në shkollën e mesme të muzikës edhe vendosëm me banu bashkë. Banonim në ni banesë shumë të vogël, të vockël kështu. Ajo ishte periudha kur m'u krijun ma shumë mundësi me vu kontakte në Prishtinë. Isha ma pak në Drenas, shkojsha thjeshtë për ndonjë ushtrim kështu teatri. Zakonisht ushtrimet e teatrit nuk ish se i mbajshim për çdo ditë kështu që e kisha mundësinë me mbajtë në të dyja antë, si të thush, aktivitetin.

Shkojsha për shfaqje nëse ish e shtune ose e diele, gjithmonë kur kisha mundësi edhe ekonomike ose shfrytëzojsha dikë që vinte me veturë dhe kish mundësi me më marrë me veti andej. Në këtë periudhë sapo isha vendosë në Prishtinë, një prej shokve të fakultetin na tregon që ka një... në fakt ky është viti i dytë është periudha... po saktë, se jom t'u rikthy datat. Në këtë periudhë ky kolegu na tregon që ka ni grup të burgosurish politikë që janë organizu dhe dojnë, si të thush, me mbajtë ni orë letrare me të cilën simbolikisht, nifar' mënyre, me shprehë revoltën e tyre për arrestimet e '93-tes.

Në '93-ten ishte periudha kur ishin arrestu veprimtar të LPK-së dhe LKQK-së së asaj kohe edhe që gjykimi i tyre po mbahej në atë kohë ose diçka e tillë. Bashkë me këtë shokun dhe me Hyrijen, me shoben time, shkojmë në Dragodan asokohe, në Arbëri e sotme si i thuhet lagjes. E gjejmë ni rreth njerëzit me të cilët pastaj kemi fillu me qenë shumë shokë e me të cilët edhe sot e asaj dite i rujmë kontaktet edhe jemi miq, miq të mirë. Aty e kemi gjetë vetën mbase edhe për shkak të frymës që është transmetu edhe për shkak të atyne materialeve që janë lexu edhe për shkak të idesë edhe mënyrës qysh na është shpjegu edhe sqaru qëllimi i tyre.

Si rezultat i kësaj fillimisht osht' mbajtë ni orë letrare në Institutin Albanologjik. Asokohe ende pa u organizu, thjeshtë si iniciativë e tyre të ish të burgosurëve politikë. Ka qenë Gani Fetaj, ka qenë [Zyrafete Lajçi](#), Zyrafete Muriqi në fakt mbiemrin e vajzërisë pastaj Lajçi, Sali Lajçi dhe Selim Lulaj. Selim Lulaj mandej është bashkëshorti im vite pasuese. Këta kanë qenë njerëzit që nifar' mënyre kanë qenë në thelbin e atij mini organizimi fillimisht. Është mbajtë ora në Institutin Albanologjik. Ka pasë edhe intelektual edhe studentë edhe profesorë.

Ka qenë... mbahet mend edhe sot e kësaj dite ma përmendin njerëzit. Ka pasë ni frymë ndryshe. Zakonisht, si të thush këto, ana ma e, hajde po themi, ma e dukshme patriotike osht' vërejtë periferive. E nuk është, si të thush, është modifiku shpesh herë në Prishtinë dhe osht' thanë me ni gjuhë ma diplomatike në Prishtinë. Po ajo orë letrare s'muj m'i thanë, e ka shpërfaqë ni gjuhë pak ma drejtpërdrejt. Kjo ju ka bo përshtypje njerëzve. Kjo orë letrare u shfaq diku në nëntor '93.

Pas kësaj është bisedu a mundemi me u organizu bashkë dhe në janar '94, diku prej 16 deri 20 janar nuk mundem me ditë saktë datën po ajo periudhë domethanë, java e dytë e tretë e janarit '94 është mbajtur Këshilli i Përgjithshëm i Sevilimit të Klubit Kulturor të Studentëve edhe pse kemi diskutu shumë gjatë nëse du me vendosë emërtimin thjeshtë Klub i Studentëve apo Klub Kulturor i Studentëve. Kemi vendosë me qenë kulturor t'u pasë... gjithmonë me shumicë mendimesh. Unë isha, personalisht kom qenë idhtare me heq atë fjalën kulturor se dojsa esencën e asaj për çka po mbledheshim.

Mirëpo shoktë të cilët ishin ish të burgosur politikë dhe t'u e ditë edhe rrezikun edhe të kapjes edhe të ndjekjes edhe pasojave që munden përmes punës me ardhë insistonin me ruajtë fjalën kulturor në emërtim. Ka vendosë me mbetë ashtu. Osht' mbajtur ai Këshilli i përgjithshëm. Ka dalë në kryesi prej atij klubi që n'fakt ky klub ishte edhe ni lloj kundërpërgjigje e ni lloj përgjumjeje studentore në ni periudhë tcaktune në Universitetin e Prishtinës. Ka qenë ni periudhë kur sikur, sikur u ba shumë e vështirë edhe sikur filloj ni tultatje, nifar' ankshti, nifar' qetësie, nifar' amullie e cila ishte e papranueshme për ni pjesë prej nesh.

Ky moment, si të thush, e ka rindezë nëse muj me thanë qat' energjinë studentore edhe rreth klubit edhe pse jetëgjatësia si të thush e veprimtarisë së klubit nuk ka qenë shumë e gjatë. Edhe prej zhvillimeve të mëpastajshme domethanë. Janar '94 është themelu si klub ka vazhdu deri afër '97-tes, domethanë deri në fund '96-tes pak a shumë. Në këtë periudhë, domethanë, ajo kryesi, ajo kryesi që doli nga Këshilli i përgjithshëm... nuk e di a është e nevojshme me i përmend me emra? Nëse veç juve ju ashtu...

Domethanë kush kemi qenë në kryesi që jemi përzgjedhë ka qenë Naim Krasniqi, ka qenë Bekim Dobraj, ka qenë Hyrie Emini që osht' vra me Tahir Sinanin ma vonë. Kom qenë unë, Alban Neziri, Bujar Dugolli, Artan Demaj. Më duket nuk harrova edhe një. Shtatë domethanë prej nesh. Të cilët në dakordim edhe me pjesën tjetër të këtyre që kishin qenë inicues fillestar po edhe të atij Këshillit të përgjithshëm vendosëm që mos me pasë kryetar. Mos me qenë dikush mbi të tjerët. Kjo edhe për shkak sërish t'u mendu pasojat që munden me ardhë për shkak të aktivizimit dhe kem funksionu si grup. Kem funksionu mirë dhe kem funksioni, si të thush, në mënyrë të atillë që asniherë nuk ka pasë as mos pajtime, as ndarje në mënyrën qysh ne kemi vepru.

Karakteristikë që ndoshta duhet me përmend në klubin osht' se, edhe nëse muj me thanë qëllimi kryesor në klub ka qenë me i absorbu, me i ofru rrymat e ndryshme të bindjeve të ndryshme dhe të mjeteve të ndryshme për çlirimin e vendit. Me e ditë njani tjetrin ku jemi, me e ditë kush jemi. Sepse në rrethana të atilla kur s'kishte informim, kur nuk njiheshim ishte shumë e nevojshme me ditë ni kontakt te kush mundësh m'u drejtu në ni moment të caktun, te kush munësh me u ofru me ni moment të caktun.

Kishte fillu me humb besimi mes njerëzve. Kish fillu gjithkush me u mbështjelle, si të thush, në guacën e vet. Ishte luftë për ekzistencë. S'mujsh me ia për të madhe kërkujt. Përveç ktyne emrave që i përmenda dhe gjithashtu që ishin, Hyrien që e përmenda, e të tjerë, Saliu, Selimi, Zyrafetja, Ganiu, Selim Gashi vëllau i Sabit Gashit. Shpijen e t'cilit pastaj janë vazhdu me u mbajtë... në odën në të cilën janë vazhdu me u mbajtë ushtrimet në muzikë. Na i shfrytëzonim të njejtën kohë edhe mbajshim takime edhe mbaheshin ushtrime me e mbajtë atë pjesë të jetës kulturore.

Në fillet e klubit, fare në fillim, dy-tre herë në fillim edhe mbasi u themelu po edhe pak para se me u themelu, ka qenë dy-tre herë me ato dhomat ku takoheshim në Dragodan ka ardhë Ukshin Hoti. Ai ka qenë, si të thush, ni ner' i veçantë në radhë t'parë me e njoftë po edhe me dëgju fjalë e tij. Në mars të '94-tes klubi pat' organizu ni tribunë politike në të cilën e kishim folës kryesor Ukshin Hotin. Ka qenë dy muj për afërsisht pa u arrestu dhe pa u dënu. Ishin shënim i demonstratave. Ne dojshim me i shënu demonstratat e vitit '81 po e ftum atë si folës kryesor, si ni dikush që kishte menim politik, si ni dikush që mundte me transmetu politikisht diçka te student, ni diçka që ishte e domosdoshme për kohën.

Kjo anë dhe mandej tjetra dhe që fillova me thanë domethanë klubi kishte mbledhë rreth vetës... edhe pse ne nuk e dishim organizimin e njëri tjetrit kush ku jemi. Po ta zëmë te ai klub, te pjesa e kangës atje ka qenë Rexhep Selimi. Te kjo pjesa këndej ku ishim ne isha unë që gjatë asaj periudhe pak ma vonë isha organizu te ose ma saktë me thanë, veproja te pjesa e LKQK-së. Ishte Alban Neziri që po ashtu ishte pjesë e grupeve që lidhej me UÇK-në. Ishte Bujar Dugolli që ma vonë merr udhëheqjen e unionit të studentëve prej klubit kalon andej dhe si të thush merr iniciativën për ma tutje.

Domethanë ka pasë... ishte Hyri Emini e cila ka qenë ni veprimtare e jashtëzakonshme. Në fund ma shumë se jetën s'ka çka jep njeriu për ni çështje kombëtare çfare shqiptartë e kanë pasë në vazhdimësi. Pastaj ishte Arianit Dema që e përmenda, Artan Demaj në fakt po ishte edhe Arianiti gjithashtu shoku që na kishte përcjellë. Të dy prej ni familje... Artani ishte djali i Isa Demajt, një veprimtar e patrioti të kahershëm. Që njëfar' mënyre grumbulloheshin ose ofroheshin fryma të ndryshme brenda të njejtës organizatë. Kjo mbase ka qenë karakteristikë që e bon me veçu veprimtarinë e klubit në atë periudhë.

Kemi mbajtë vazhdueshëm takime në ato salla ku mbaheshin mësimet, në ato salla kryesisht në Dragodan. Derisa në mars, se e pamë edhe te fotografitë diku, në mars të vitit '96 nëse nuk gaboj një diçka pak ma e madhe ka qenë mbajtja e një aktiviteti bashkë me rektoratin. Deri atëherë kishte nifar' refuzimi për klubin. Sepse shiheshim ma ekstremist, shiheshim më skajshëm dhe frymat politike të asaj kohe nuk ishte se na pranonin krejt krah hapur. Natyrisht që ne kishim, nuk po them prapavijë, por në mbështetje ish të burgosur politik, vazhdueshëm të burgosur politik. Bajram Kosumi, Selatin Novosella, Nait Hasani, Hydajet Hyseni ni kohë. Që kanë ardhë e kanë ndjekë aktivitete të klubit.

Në këtë përvjetor që po them të shënimit të demonstratave të '81-shes sërish po tash në '96-ten na u mundësu, na u leju që të majmë aktivitet në ato lokale të rektoratit të asaj kohe. Në Velani diku ishte

ajo hapësira ku na u mundësu kjo gja. Aty kishte ni frymë pak ma ndryshe prej asaj frymës së përditshme në Kosovë, frymës së shumicës. Po që për neve ka qenë diçka që kishte ardhë koha me ba. Mendoj që në këtë kuptim klubi e ka pasë, e ka pasë efektin e vet.

Anita Susuri: A keni pasë ndonjë përcjellje? A ka ditë për shembull pushteti i asaj kohe për ekzistimin e këtij klubit? Për punën?

Majlinda Sinani Lulaj: Jo. Nuk e di a ka ditë a s'ka ditë. Në kohën kur mandej jam arrestu jam marrë në pyetje edhe për pjesën e klubit. Në bazë të asaj çka jom pytë mendoj që nuk kanë ditë shumë. Ndoshta kjo prap, ajo, si të thush ajo parashikimi që po ky grup duhet me pasë edhe fjalën kulturore brenda deri diku e ka shpëtu klubin pa, pa e konsideru si diçka që kish mujtë me psu dikush prej kësaj. Ne jemi arrestu dy-tre njerëz, si të thush, prej klubit kemi qenë si emra. Unë e arrestune, Albani i arrestun, Rexhepi, Rexhep Selimi pastaj. Po jo si... secili për aktivitete që kishin bo tjetër kah po jo si të klubit.

Domethanë na nuk jemi dënu si të klubit. Nuk është se kanë ditë shumë për klubin. Ndoshta edhe pse, nuk e di, kishte ni frymë ndryshe atyne viteve të fundit. Fillun njerëzit... ndoshta edhe ne targetet kah i kishim ishin njerëz ma të besueshëm. Njerëzit që i thirrnim ishin njerëz që i konsideronin frymës tonë. Mënyra ndoshta qysh e transmetonim nëpërmjet poezish ndoshta ishte pak ma publike sesa të tjerët. Ndoshta mund t'mos jemi pa me synin shumë t'rrezikshëm edhe pse ne kemi qenë t'kujdesshëm vazhdueshëm. Kjo besoj që na ka shpëtu deri nifar' mase.

Anita Susuri: E këto aktivitetet, tubimet, bisedat domethanë që janë bo, ku i keni bo zakonisht?

Majlinda Sinani Lulaj: Në banesa.

Anita Susuri: A keni pasë...

Majlinda Sinani Lulaj: Jo, jo, jo. Në banesa studentësh. Kryesisht në Dragodan. Ishte banesa, nëse nuk gaboj aty banonte Ganiu, Gani Fetaj. Edhe ai ni ish i burgosur politikë qysh kur ka qenë 16 vjeçar, n'moshë shumë t'hershme. Sot jeton në Zvicërr se ka pasë edhe ai historinë e jetës t'vet. Por që pak a shumë aty. Kryesisht në banesën ku ishte ai po edhe të tjerë student se ata banonin si grup. Ishin, shumica kanë qenë djem të Dukagjinit domethanë n'anës Pejë, Deçan andej. Mirëpo kishte edhe të anëve tjera që pastaj bashkangjiteshin aty.

Nuk kemi qenë grup i madh. Domethanë shpesh takoj njerëz që e përmendin klubin dhe ndihen pjesë e klubit se kanë ardhë në aktivitetet tona kur i kemi ba. Po thelbi i klubit nuk kemi qenë shumë, nuk kemi qenë shumë. Maksimumi nëse jena mbledhë në atë kshill të përgjithshëm ku kemi qenë, kena mujtë me mbledhë 40 vet. Shto edhe nja dhjetë që kanë qenë ky krahu tjetër që nuk e kanë konsideru vetën as anëtarë të këshillit po thjeshtë na kanë mbështet. Rreth 50 vet. Pastaj punën e kemi vazhdu

këta shtatë që ishim në kryesi dhe eventualisht një dhjetë, 15 vet. Maksimum 20 nëse dikush i ka përfunduar studimet ndërkohë e dikush tjetër ka ardhë.

Kaq ka qenë thelbi i njerëzve, si të thush, që e kanë ru edhe frymën po edhe mos me, mos me rrshit prej durve ajo mënyrë për çka ish ideu edhe ish mendu klubi. Mendoj që në pjesë e veçantë edhe energjisë edhe jetës time ka shku aty, dhe jo veç e imja. Mendoj që kemi qenë... kështu kemi përfaqësu, si të thush, ndoshta kemi qenë simbolika e një brezi, me të vërtetë. Edhe për shkak se t'organizimit ndryshe ndryshe që e kemi pasë. Po kur jemi mbledhë aty nuk e kemi vërtetë dallimin. Na kemi marrë vesh për një tjetër kush ku ka qenë veç nëse jemi arrestu ose tash mbas luftës kur jemi ulë e kemi bërë muhabet.

Domethanë na kemi shku, kemi funksionu, kemi punu pa i tregu një tjetër kush edhe çfarë pune tjetër po bënë anash. Kjo periudhë derisa unë fillova me punu në arsim. E përmenda edhe ma herët. Atëherë kom fillu ma pak me qenë, personalisht po flas, ma pak me qenë aktive në Prishtinë. Sepse e kisha të pamundur. Domethanë visha ndoshta në ligjerata paradite deri në mesditë. Kthehesha në mesditë dhe shkojsha majsh mësim. Ose e kundërta, varësisht qysh i kisha oraret. Ishte pastaj orari i ushtrimeve, nëse kishim teatër ose recitim ose ndonjë takim. Mbajshim edhe ndonjë mbledhje.

Thirrshim nganjëherë, ta zam në atë kohë, sikur gjithandej në Kosovë ka qenë Lidhja Demokratike, si të thush, e organizune edhe forumet e rinisë edhe zhvillonin aktivitet edhe mbledheshin. Personalisht nuk është se... edhe nëse kom shku kom thanë, "A keni diçka konkretisht? Nëse s'keni..." unë kam qenë kështu, ma e skajshme në qëndrimet e mia. Thashë, e kam këtë kokëfortësinë edhe mos futjen brenda kornizave. Po kjo ka qenë mënyra jem qysh unë kom vepru edhe shpesh herë ndoshta m'ka shpëtuar prej do momenteve që... t'veprimit si asket kaniherë është e çuditshme si të veçon edhe qysh... ose të mbron ose të vendos në pozicion jo fort të lakmueshëm po unë kom vepru shpesh herë qashtu.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Tash po m'intereson rrethanat e burgosjes. Ku keni qenë? Çka ka qenë aktakuza?

Majlinda Sinani Lulaj: Ndoshta para kësaj, gjatë kësaj periudhe intensive që po them edhe të klubit edhe të punës edhe të aktivitetit në Prishtinë edhe të studimeve, po ashtu në '93-tën ka qenë besoj qershori ndoshta ose nuk mundem me ditë saktësisht, po domethanë mbasi ka dalë trakti i parë i LKQK-së. Ka qenë në vendas i jemi, në Ilir Tahiri që e përmenda të fotografitë, në djalë që ka qenë, ka marrë burg në periudhë. Ka qenë i organizun edhe i dënuar. Jo se dija shumë për aktivitetin e tij por se e njihja në Drenas. Si të ri njiheshim. I cili ma sjellë një trakt.

Se unë vazhdueshëm t'u thanë, "Çka me bo diçka, duhet me punu diçka, duhet me ba diçka". Me të njihesha e lirë me folë t'u e ditë edhe n'moshë ishim ma afër po edhe t'u e ditë t'kalunën. E kujtoj që ma solli të palosun. Ajo kishte qenë një, kështu e formatit ma t'madh. Ma solli t'palosun ashtu edhe në xhep. Më thotë, "Po të jap diçka", thotë, "po jo me hapë këtu". Unë e hapë tek mandej atë material, e lexoj dhe ai ka qenë kontakti jem i parë me çlirimin dhe me LKQK-në, si diçka ilegale po themi për atë kohë.

Se këto tjerat i bonim më publikisht në atë kohë. Së paku nuk i thoshim vetës se jemi ilegal. I bonim. Me të zanë ndëshkoheshe po për sa kohë nuk nxiheshe veprimtaria zhvillohej. Ky ka qenë momenti i parë. Po mandej në ndërkohë gjatë periudhës sa ishim ofru te klubi unë kisha njoftë Hyri Emini. Hyri Emini gjithashtu kishte ni afirmitet me pjesën e LKQK-së. Ni periudhë të shkurtë kemi banu bashkë me të edhe ajo, nifar' mënyre, ma trazoj rrugën në kuptimin e asaj se çka m'foli, për qëllimin po jo si kërkesë e drejtpërdrejtë. Thjeshtë bisedonim si, si bindje, si ide, si frymë, si rrugë.

"A është ajo çka duhet? Ku duhet me u gjetë na? Çka mundemi me bo na?" Domethanë ishin biseda, kaniherë thom të zakonshme po ndoshta jo secili i ka bo. Na i kemi bo, i kemi pasë goxha të theksune. Kjo periudhë pastaj dhe gjithashtu ai Këshilli i përgjithshëm i klubit në të cilin mes të tjerëve ishte edhe Nazmie Klinaku, mundësoj me u njoftë me Nazmien. Ajo pastaj përgjatë ditëve më vendos në kontakt m'thotë, "Ka kërku dikush me të taku". Nuk ma thotë emrin, nuk më tregon kush. Po toni me të cilin ma tha m'boni me ditë që nuk është ni diçka e jashtëzakonshme është diçka ma e veçantë.

Sot me m'pytë si ka qenë e ku ka qenë takimi i parë nuk e kujtoj. Me ni person të cilit ia kom kuptu emrin tek kur jemi ra n'burg, e kur jemi dalë n'sallë të gjyqit domethanë. E kom besu që i njeiti person edhe emri po lidhen domethanë. Ka qenë, besoj ka qenë vjeshta e, ndoshta vjeshta e '95-tes pak a shumë. Aty jom vu n'kontakt t'parë me illegalen. Kom pranë materiale kryesisht çlirimin, të cilat ishte kërku prej meje t'i sillja në Drenas. Në Drenas pastaj m'u kërkua që ta kontaktoj një djalë, ata nuk e dishin që e njoh fillimisht. Po kur m'pytën thashë, "Po, unë e kom pasë shok klase". Ishte Sami Hyseni.

"A mundësh me taku dhe thjeshtë me ia dhanë 'Çlirimin' ai e din çka me bo me to?" Takohem unë me të. Kisha marrë ni aprovim paraprak prej tij që po pranon. Në fakt mas luftës e kom kuptu se ai kishte qenë i organizun edhe ma përpara, po unë aq sa m'thuhej. Nuk është se bëj pyetje shumë. E kujtoj momentin e parë kur unë kom pasë me shku me ia dorëzu 'Çlirimat' e parë për m'i shpërnda në teren. Qëllimi i 'Çlirimit' ishte që me kriju masë të atillë edhe vetëdije të atillë që me qenë të gatshëm ni moment me iu kundërpërgjigj jo thjeshtë me qetësi atij regjimi që po vazhdonte, si të thush, me zhduk gjithçka që ish e jona.

Në këtë kohë, para se me dalë atë natë, para se me dalë... tash mundeni me marrë me mend ni periudhë isha ma e madhja në familje dhe vajzë. Jo se isha fëmija domethanë që m'kanë majtë nën kontrollë ku po shkon e ku hyne e ku dole po megjithatë me dalë në 12:00 të natës ose 01:00 të natës ose 02:00 të natës ishte jo e zakonshme. Sepse kishte patrulla, nuk ishte as e sigurt, kishte patrulla të

policisë. Shpesh herë kishte orë policore, domethanë s'ishte normale me ju thanë prindërve, "Unë thjeshtë po dal".

I mbledha mamin edhe babin të dy në dhomë edhe ju them, "Unë kam vendosë", kam vendosë, "kam hy ni rrugë në të cilën ka me u dashtë me dalë me orar, pa orar, me bo, me lëvizë", pa ju thanë gjatë, thjeshtë si të përgjithshme. "Dhe e kam veç ni kërkesë prej jush, a mundeni me llogaritë sikur i keni vetëm pesë fëmi tjerë edhe nuk m'keni mu edhe thjeshtë mos me m'pytë ku po shkon, ku po hyn, ku po del se nuk mundem me ju thanë". E kujtoj babi nuk ka folë asni gjë. M'pa kështu në sy ma ka njoftë kokëfortësinë. E ka ditë që edhe me fillu me debatë diçka me mu nuk ecën.

E kujtoj nanën që m'ka thanë thjeshtë, "A e ke mendu mirë?" Edhe i kom thanë, "Po. Unë e kom mendu mirë". Nuk m'kanë pytë as çka as qysh. Po atë natë jom veshë me ni gjup të vëllait, pak ma e madhe. I kom mshefë floktë, i kisha shumë të gjata. I kom fut mrena asaj dhe kom dalë me taku këtë shokun tem, me të cilin kisha bisedu paraprakisht dhe e kishim caktu ku po takohemi bashkë. Në momentin kur ia kom ofru "Çlirimat" m'thotë ai, "Kthehu tash". Në fakt mu kërkush nuk m'kish thanë me dalë. Mu m'kishin thanë të dorëzoja "Çlirimat", qita. Çka ishin të pshtjelluna aty, "Dorëzoja".

Jemi taku te hekurudha në Drenas. Unë i them, "Ku me u kthy unë?" Thotë, "Kthehu në shpi tash ti se unë e kryj". I them, "Jo, unë nuk mundem me t'lanë vetëm". Se m'dukej e pa drejtë. M'dukej unë po jep diçka e po tërhiqem në shpi dhe po e la te rreziku. Kom vazhdu me të. Kom dalë kështu me të, aq hera sa e shpërndam. Derisa ni moment kur vija në Prishtinë me i marrë këto materialet çkado që marrsha, në ato pak minuta, minuta me thanë, domethanë, sa ndërrojsha fjalë me këtë personin që e takoja që jetonte, shihej që jetonte ilegalisht. Me këmishë zhubrosun, era duhan edhe materialet që i merrsha edhe afërsisë thjeshtë komunikimi kur zhvillohej...

E them ni fjalë që n'kuptimin e la me kuptu, "Kemi dalë", kështu diçka, "Kemi dalë m'i shpërnda". Thotë, "Prit, prit, prit po del edhe ti?" Thom, "Po se unë nuk mundem me lanë vetëm". Thotë, "Mirë", thotë, "ne s'kemi thanë me dalë po ti e paske bo. Në rregull, vazhdo". Dhe kemi vazhdu kështu. Në ndërkohë është kontakti edhe Enveri. Më është kërkë me kontakti edhe Enverin, [Enver Dugollin](#), me ta kemi qenë bashkë. Ai pastaj i ka vu edhe ai kontaktet me... unë nuk e dija me kënd po thjeshtë unë e kom bart porosinë që, "Dikush ni shok i joti i burgut po don me të taku". Ku ta di unë çka.

Kështu ka vazhdu si me thanë angazhimi deri në, deri '96-ten dikur kur e kemi riaktivizu, jo riaktivizu, e kemi aktivizu edhe Shqipe Ahmeti. Ni... edhe e kisha afër kështu me shpi, shoqe, afër, fqinje. Po në anën tjetër ka qenë shpërndarja e fundit e çlirimit që e kemi ba. Diku tash fundi i '96-tes nuk muj me ditë saktë, dimër. Kemi shpërnda çlirimin në ni territor ma të madh se zakonisht se u bom tre edhe patëm guximin me lëvizë pak ma gjatë. Megjithatë në janar, në atë periudhën ku qysh e pam prej fotografive ishte periudha kur mbahej Flaka e janarit, ku shënoheshin si të thush ato data, përvjetorët e vdekjes të Jusuf Gërvallës, e Kadri Zekës e Bardhoshit.

Ishim në flugun edhe të kësaj pjese domethanë. Në të njejtën kohë shkojsha në studime, në të njejtën kohë në arsim, në të njejtën kohë shpërndajsha natën material ilegal, në të njejtën kohë jo se janë këto programet e ku duhesh m'u aktivizu. Isha t'u e përgadit temën e diplomës, i kisha përmbyllë provimet e mia deri në '96, nëntor '96 diku dhe isha thjeshtë temën e diplomës t'u e përgadit. Diku ndoshta nga mesi i saj, janar, me 26 janar ndodhin arrestimet e para.

I kom... kom qenë mramje, kom qenë në shpi kur kom dëgju. U përmend emri i Avni Klinakut, nëse nuk gaboja asokohe. Mirëpo fakti se unë nuk e dija si emër kështu po nuk e kisha idenë kush osht' edhe qysh doket edhe asni gja tjetër. E kujtoj vetën që në momentin kur ju ka përmend emri unë vet me vete kom thanë real qysh ka mundësi me zanë. Se unë kisha informacion që ky njeri është në ilegalitet të thellë edhe nuk, nuk zinet, si me thanë, ajo bindja e brendshme e jona që kur je në ilegalitet je ma i mbrojtun, ku di unë çka.

Data 26. Me datë 27... unë në atë kohë isha t'u punu në shkollë fillore, në një shkollë fillore. Ato dy vite domethanë punë që kisha ba në arsim, në Çikatovë të Re. Ni fshat shumë afër Drenasit. Mijsha me shku n'kamë s'ish diçka që duhej ndonjë mjet transporti. Me datë 27 mëngjes jom nisë për punë. E kisha dëgju si informatë po nuk m'kish... arrestoheshin për çdo ditë njerëz, merreshin biseda informative për çdo ditë njerëz. Domethanë nuk më sinjalizoi diçka shumë specifike. Po arrestim, po ni emër u përmend.

Me datë 27 unë shkoj në punë, kthehem kah mesdita. Nana jem m'pret te dera dhe thotë, "Ka ardhë vëllau Enverit, Iliri, edhe thotë ka thanë që, "Enverin e kanë arrestu edhe të vetmen fjalë që ma ka thanë n'fund para se me pamundësu me folë ka qenë, 'Tregoj Majlindës që m'kanë arrestu'". Në momentin kur e kom marrë këtë informatë i vetmi veprim i jemi ka qenë qysh m'i informu dy njerëzit e tjerë me të cilët isha në kontakt. Ma së afërmi e kisha Shqipen. Jom nisë meniherë në... thjeshtë kisha me kalu rrugën, shumë afër domethanë.

Po kur jom afër kom pa njerëz prej Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut e kështu edhe që po bisedojshin me za dhe asi. E mora vesh, në të kalun, jo me u ndalë me folë sepse vazhdoja me besu... tashti kishte dy anë njana me kallxu tjetra mos me u dekonspiru. Sepse nëse eventualisht nuk ka ra linja, nuk kish nevojë me u zbulu ma shumë. I ndëgjoj t'u folë se veç ka pasë bastisje ose kanë kërku kështu diçka në shtëpi, diçka e tillë. Nuk e disha çka ka ndodhë krejt dhe sa kuptova derisa kalova ishte se nuk e kanë gjetë në shtëpi Shqipen, që ishte shenjë e mirë për mu.

Mirëpo që më, si të thush, e nxiti te unë bindjen që ndoshta edhe Enveri po ndoshta edhe Shqipja, për shkak se në atë kohë s'kishte pak ditë, ni javë ose dhjetë ditë që ishte themelu Partia Parlamentare dhe kishin fillu degët e Partisë Parlamentare, më doket e udhëheqke aso kohe Bajram Kosumi, mos gaboja. Një ish i burgosur tjetër politik. Si të thush në atë periudhë mendova mos ndoshta i kanë arrestu për këtë arsye. Sepse shihej si ni parti ma më ndryshe prej rrymës tipike pacifiste çfare ishte LDK.

Kom vazhdu ma tutje të shtëpisë të tezës time tek e cila shpesh herë jom shërby me telefonin. Unë s'kisha telefon në shpi. Kur jom ofru te dyrtë e shtëpisë të saj, se kom dashtë me ba ni telefonatë prej saj. Jom kujtu me vetën dhe kom thanë mos eventualisht diçka dhe nuk po e rrezikoj edhe dikë tjetër dhe jom kthy mrapsht. Kom shku në postë. E kom pasë afër shpisë. Qendër e vogël. Postën njërën anë. Jom shku te posta e qytezës. Kom thirrë n'telefon Nazmien. Nazmie Klinakun e cila m'kishte vu në kontakt me një person me të cilin unë takohesha po nuk e dija kush është. Dy-tre vjet domethënë rresht.

Dakordohem me të me u taku të nesërmen sepse s'kisha autobus më kur me shku edhe kur me u kthy. Me u taku me të nesërmen. Me datë i binte 28. Me datë 28 kom ardhë në Prishtinë. Me 27 s'ndodhi te unë asnjë, nuk vrejta ndonjë lëvizje tjetër. Samiun tentova me marrë në telefon që me i thanë, ishte në Prishtinë, me i thanë diçka, që mos eja në shpi. Nuk mbrriva. Me datë 28 vij në Prishtinë. Takohem me Nazmien te pjesa e kurrizit, te ora e kurrizit i thoshim ne atëherë. Zbres aty takohem me të.

Bisedojmë i tregoj edhe ajo m'thotë, "Po", thotë, "na kanë bastisë edhe ne në shpi. Na kanë marrë", nuk e di a i kishin bastisë ose jo po kështu, "na kanë marrë në shpi", si familje domethanë. Edhe thotë, "Po na kanë marrë në pyetje na kanë liru. Ata po thojnë që e kanë marrë ni vëlla temin që është ilegal", nuk m'thotë që osht' personi që e ke taku, asni gja tjetër. Thotë, "Po", thotë, "nuk po besojmë që është e vërtetë". Po t'njejtën bindje që realisht e kisha edhe unë. Se nuk m'rrishe me perceptu drejtë situatën. Mirëpo atë ditë derisa erdha, ishte "Bujku" aso kohe që nganjëherë kështu si të thush nxirrte edhe kësi lloj informata. Jepte informata që ishte arrestu Shukrie Rexha në atë kohë.

I them... interesohem tashi kush është, "A po e njeh?". Edhe pse aty thuhej që është aktiviste e LDK-së nuk thuhej që i ka taku diçkafit tjetër. Ajo thotë... nuk m'jep shenjë domethanë. Gjatë gjithë kohës e ruajshim njani-tjetrin prej informatave të tepërta. Njëllor siç nuk bënim pyetje ma shumë sesa që duhet sepse rrethanat ishin të atilla që shpesh herë sa ma pak me ditë ishte ma mirë. Kuptoje ose bëje pyetje veç sa duheshte për me funksionu, po jo ma shumë. Edhe tjetri nuk të jipte ma shumë informatë sesa ishte e nevojshme me ditë ti me ni moment të caktun.

Po m'thotë Nazmia, "A niresh e rrezikune?" "Po kom përshtypjen që nashta janë thjeshtë për shkak se janë aktivizu te Partia Parlamentare edhe besoj që i majnë biseda informative dhe i lirojnë". Shqipja nuk ishte arrestu po ishte vetëm Enveri i arrestun. Mirëpo i thom, "Duhet patjetër me kërk Samiun". Shkojmë bashkë me Nazmien te Fakulteti Elektroteknik ku i kishte shpijat ku i mbanin ligjeratat. E dinte Nazmia ku i mbanin se ajo ishte studente e elektroteknikut. Ishte edhe ajo afër diku asaj pjesës Kodrës së Trimave, nuk e kujtoj saktë. Po nuk e gjetëm. Mbeti porosia te Nazmia që, Naza si i thom unë, që me njoftu Samiun nëse mbrrin.

Në këtë periudhë, domethanë, në këtë mes afrohemi te plepat me hyp në urban unë dhe me u kthy. Secila rrugë e veta. Unë kisha me u kthy në shpi, ajo me vazhdu në shpinë e vet. Aty takohem me Bujarin, me rastësi, me Bujar Dugollin, vëllaun e Enverit. Ai u habit kur na pa bashkë. Bujari s'e kish

idenë as të aktivitetit tem me vëllaun e tij as të aktivitetit tem në ilegale. Domethanë ishte... sado që njiheshim, punonim bashkë ni drejtim, për pjesët tjera të jetës tona personale nuk dinim. Veçojmë, ndahemi prej Nazmies. Ulemi me Bujarin, ishte ni ëmbëltoe e vogël nuk e harroj aty në qoshe ka qenë, nuk e di a është ma me të thanë të drejtën, nuk e kom mendu ndonjëherë.

I tregoj, i thom, “T’lutem mos u kthe në shpi se Enveri është...” se s’kishte informatë as ai, s’kishte telefon përpara. Ishin veç këto kontaktet kur mbërrijshe me i bo. E kujtoj domethanë atë moment të vështirë edhe për të edhe për mu se nuk e dinim kërkush nuk e dinim për çka. Ishte ma e randë sepse Enveri ishte edhe ish i burgosur paraprakisht dhe e dishim që secila mbajtje ma gjatë e tij është ma e randë sesa për dikë që arrestohet dhe burgoset për herë t’parë. Rikthehem unë atë natë sërish në shpi. Kujtoj nanën time ato dy netë rrinte zgjutë se s’e dishim, nuk e dishim çka po ndodhë.

Me datë 29 m’kishin thirrë në shkollë, në gjimnaz me fillu, si të thush, si zavendësim, isha pranë diplomimit, me zëvendësu ni profesoreshë të gjuhës shqipe që kishte shku n’pushim t’lindjes. Në mëngjes herët ishte vëllau i vogël, ishte nana edhe baba dhe ju them, “Nëse eventualisht vjen dikush”, se vishin t’kërkojshin në biseda informative ose... nuk e dishim qysh sillen rrethanat. Them, “Nëse m’kërkon dikush i thoni ka shku në punë, pa e precizu, ka shku në punë ose në fakultet”. Ishin dy rrugë. Fakulteti ishte diçka që ata s’e donin se me të nxon rrugës e me indeks, pësoje edhe ashtu. Po sidoqoftë këto dy alternativa që ju lash në shpi.

Vëllau i vogël që s’ishte shtatë-tetë vjet në atë periudhë kaq ka ndëgju, kaq ka mbajtë mend. Nisem unë shkoj po jo në punën në shkollën fillore ku jepsha mësim po atë ditë shkova në gjimnaz. Sepse m’kishin thirrë me fillu, si të thush, ni periudhë nantë muj a ni vit sa ishte pushimi i lindjes me zëvendësu këtë profesoreshën dhe nifar’ mënyre me fillu punë në gjimnaz. Nisem shkoj në gjimnaz në punë. Në ndërkohë m’kërkojnë në shpi sigurimi shtetnor. Del... i mshojnë ziles. Sa kishim fillu diçka kishim zgjeru te shpija ni gjo dhe ishte si të thush dhomat ishin goxha larg prej hyrjes. Po ka qenë ni rrugicë shumë e vogël për me hy te shpija, nuk ka pasë ni rrugë të lirtë kështu me hy n’oborr.

Del vëllau i vogël. Pytja e parë që ju ka ba, “Çka e ki Majlindën?” “Motër”, “Ku osht?” Ai çka m’ka ni mu që ju kom thanë prindërve, ai qaq ka interpretu. Thotë, “Ose n’punë ose n’fakultet”, “Babën a e ki këtu?” “Baba ka ardhë prej punës me hangër mëngjes”. Atëherë ishte mëngjesi në ora 10:00 kështu, i lejshin me demek ni gjysë ore pushim. Ai e kishte afër punën. Del baba. “Ku e ki çikën?” Edhe ai po t’njejtën gja e thotë se kaq ishte porosia që i kisha lanë. Thotë, “Duhet me u lajmëru në bisedë informative”. Niset. Baba jem niset për punë dhe vjen te unë në gjimnaz dhe thotë, “Kanë ardhë t’kanë kërk. Nëse e din vetën që domethanë mate ku je”. Nuk e dinte ai as çka kisha bo, as ku isha, as çka.

E shoh orën ishte 11:00-10:30 kështu. E llogaris bisedë informative këta zakonisht t’majshin dy orë, tre orë, katër orë t’lirjoishin. Mujshin me të thirrë prap, kështu zhvilloheshin proceset. Sepse hala s’kishte ni rrugë, nifar’ mënyre ni sinjal që po ndodhshin arrestime. S’paku s’kishte informatë. Arrestimet kishin pasë ndodhë po kur s’kishim informatë nuk kishe qysh me ditë. Them bisedë informative, mos t’më

çojnë në Prishtinë më kryjnë ktu edhe kurgjo, a din. Kthehem unë. E lo çantën e marr ni letërnjoftim thjeshtë me vete edhe lajmërohem në bisedë informative.

Aty pastaj vazhdon ajo pjesa tjetër domethanë. Fillimisht niherë nuk e besojshin që jom unë. Sepse unë kisha pasë gjatë kësaj periudhe kur kisha nxjerrë për herë të parë letërnjoftim, ma kishin vjedhë niherë letërnjoftimin, e kisha nxjerrë ni letërnjoftim të dytë. Fotografitë e mija prej herës së parë dhe të dytës dallonin shumë. Ata gjatë gjithë kohës më paskan kërkua me fotografinë e letërnjoftimit të parë të cilën e kom nxjerrë në Drenas, në Gllogovc. Aty kom qenë ma e plotë, ku di unë, kom dalë ni periudhë verës dhe nuk përngjaja me fotografinë e dytë. Derisa fati e kisha atë letërnjoftim me veti se filloj ai presoni që ti s'je Majlinda.

Mandej kur u bindën që jam unë atëherë me ato motorollat që kishin, aty e kom marrë vesh që në të njejtën kohë kur m'kanë kërkua në shpi kanë çu ni autobлинд më kanë kërkua në shkollën fillore ku kanë mendu që jom t'u punu. Në të njejtën kohë kishin qit' ni punkt, ose si i kanë thanë, në Komoran t'u mendu që kom mujtë me shku në Prishtinë dhe në Fushë Kosovë. Sepse janë njoftu pikat t'u ju thanë që ajo është këtu dhe domethanë personi, Majlindën mos e kërkoni se ajo është këtu.

Domethanë katër-pesë orë jam mbajtë... katër-pesë orë deri në ora 04:00 kur e përfundojshin ata orarin në Drenas, jam mbajtë në Drenas. Pastaj më kanë sjellë në Prishtinë në ndërtesën e sigurimit shtetnor, kujtoj se ka qenë. Një ndërtesë që si duket gjatë luftës është bombardu prej NATO-s. Kjo ndërtesa pas Burgut të Prishtinës, ka qenë shtatë-tetë katëshe, nantë katëshe, nuk e di. Po e di që m'kanë ngjitur në katin ma të naltë. Aty ka vazhdu pastaj marrja n'pytje e këtij inspektorit shqiptarë që ish realisht që kur më mori në Drenas, ka qenë ni Isa Bunjaku i Gjilanit.

Mandej në Prishtinë kanë qenë dy inspektor që kanë vazhdu me më marrë në pyetje edhe në kohën masi m'kanë çu në Lipjan, ni Branko edhe ni Zharko, mbiemrat nuk ia di. Kaq i kom ni t'u u thirrë mes vete. Të tjerë inspektor që kanë hy e kanë dalë në zyre t'u mos, si me thanë, nuk është se bënin, përveç një që u prezentu si shefi i tyne i cili m'ka bo disa pyetje. Por që të tjerët kanë hy e kanë dalë po nuk m'kanë bo pyetje. Thjeshtë ajo pjesa e shantazhit domethanë ose ofrimit deri afër te ftyra ose e kërcënimit, e sharjeve. Mënyrat e tyne, metodat e tyne të... si të thush edhe të presionit.

Diku rreth mesnatës nashta pak ma vonë m'kanë nisë për Lipjan edhe në Lipjan m'kanë çu diku me 29 domethanë 30 t'u u bo 30. Besoj ka qenë mas orës 12:00 t'natës. S'kisha... orën e kisha n'fakt po nuk mbrrisha me e pa. Gjatë gjithë kohës jom kanë e ulun, m'kanë ulë me shpinë kah dera dhe krejt lëvizjet e tyne i kom pa vazhdueshëm në xhamin e dritarës që i kom pa. Po flas në ndërtesë, sa isha në ndërtesën e UDB-së këtu. Mandej në Lipjan... se nuk ka përfundu marrja n'pytje këtu, kanë vazhdu përveç periudhës dy ditore para se me m'pru te gjyqtarja hetuese që kjo Danica Marinković e famshme, kanë vazhdu me më marrë në pyetje edhe mbas periudhës. Diku rreth dy muj unë kom vazhdu me u marrë në pyetje.

Nuk ka qenë kjo pjesa që lidhej me çlirimin edhe me LKQK-në, ishte njana pjesë e presionit. Po fakti se, si dukej, ishte përmendur emri im goxha shumë gjatë procedurave që ata i kanë ndjekë edhe me të tjerët edhe kështu në aktivitete të ndryshme se pynin për gjithçka domethanë, nuk kishte pse mos me t'u përmend emri sepse ishte pyetë për gjithçka. Domethanë për çdo gja. Atëherë ata vazhdojnë me ba presion. Për shembull te unë kanë bo presion shumë se mund t'jem pika e kontaktit ose si të thush ndërlidhja mes grupit të UÇK-së dhe grupit të LKQK-së. Nuk ka qenë e vërtetë n'fakt.

Unë vërtetë kam njoftë njerëz, ma shumë njerëz kam njoftë te grupi i UÇK-së sa që kam njoftë te grupi i LKQK-së po që s'kam qenë pika e kontaktit. Njerëz kam njoftë, kom qenë afër me ta. Ndoshta moment i mirë me u ni mirënjohëse edhe falënderuese prej shumë djemëve që m'kanë njoftë, kanë ditë për veprimtarinë teme po që nuk kanë folë dhe që nifar' mënyre e kom kalu edhe unë ma lehtë nëse muj me thanë atë periudhë. Natyrisht na jemi gjyku e jemi dënu si grup.

Ndoshta është me rëndësi me përmend që në atë periudhë sa kam qenë mrena kanë qenë dy momente. Se aty domethanë në momentin kur s'e ke asnjë informacion se çka po ndodhë prej jashtë dhe je nën trynën e vazhdueshme të marrjes në pyetje domethanë je nifar' kaosi edhe informatave edhe të asaj qysh munësh ti me u gjetë. Po kanë qenë dy momente që ma kanë ndihmu, nëse muj me thanë, mënyrën qysh unë kom procesu me situatën.

Njëna, si me thanë, zakonisht është rregull te burgu që kur i pranojnë të burgosurit, para burgosun se realisht ne ishim në periudhë hetime me i çu n'kontrollë te mjeku. Po mu nuk m'kishin çu dhjetë ditë ose dy javë fare. Mbas asaj periudhe në momentin kur m'dërgojnë atje si duket e konstantojnë se isha pa gjum vazhdueshëm t'u u marrë në pyetje me orë të tana natën, isha krejt e pa gjum, e nxine pjesët poshtë. M'kanë tregu të tjerët që m'kanë pa se unë vetën s'kom pasë ku me pa, s'ka pasë ni pasqyre ose diçka të tillë.

Kur kthehem në dhomë, ishte ni gardiene shqiptare e cila m'thotë, "Pusho, shtriju pusho". Se nuk kishin të drejtë me u shtri në shtrat. Unë t'u mendu që po m'provokon nuk u shtriva. Ndodhi aty nifar' lloj diskutimi me të pak ma i gjatë. Ndërkohë ajo ma bon me dije që ti je shumë keq, je para kollapsit se... unë nuk e hetoja në fakt. Po si duket tensioni kishte dalë shumë i ultë dhe ndoshta mjeku i kishte sinjalizu diçka ose diçka e tillë, s'mrrijsa me shpjegu. Ni moment mu nuk m'lejojsin në fakt as revista, as libra, as kurgjo. Dy mujtë e parë s'kom pasë asnjë. M'kujtohet që kjo gardienja shqiptare ofrohet te qelia, te vendi ku mbahej Shukria edhe i thotë, "M'jep diçka t'i jep me lexu". Se Shukrijes veç i kishin leju me lexu diçka.

Ajo... ma vonë e kom kuptu që jo krejt rastësisht domethanë ia jep njo dy pjesë të ni, unë kujtojsha Kosovare po ndoshta s'ka qenë, nuk e di çka ka qenë. Në të cilën ka pasë ni informatë për arrestimet jashtë. Për grupet që po tentohen me u bo se po mbahet ni person, që s'po dihet ku osht' e gjana të tilla. Që nifar' mënyre më kanë orientu në krejt kaosit e pyetjeve që m'janë bo. Ka qenë ni vajzë që e sollën, e arrestun dhe e sollën brenda, ni Hava Lokaj, nëse s'gaboje kështu e ka pasë emrin dhe

mbiemrin se ka kohë që nuk e kam taku. Që n'atë kohë e sollën si pjesë të grupit të UÇK-së. Unë nuk e dija deri në ni moment të caktun. Po fakti që e mbanin vetum në dhomë m'bojke me besu që është e lidhun me politikën diçka.

Një nga të dielat kur kishte gardiene shqiptare, kishte ma pak gardiene aty ose na ruanin vazhdueshëm. Kena pasë tre kontrolla prej katit deri te dhoma ku mbaheshim, ku mbahesha se mbaheshim veçmas edhe unë edhe Shukria në atë kohë. Se dy ishim, ne edhe kjo e treta, kjo Hava. Afrohem në njëren prej ktyne, rrezikoj, afrohem te kjo vrima n'derë, na i thojshim shpahun, kjo është termi që përdorin zakonisht. E hap atë dhe ajo ma përpara s'kishte pranë me ju përgjegjë ktyne grave tjera dhe thoshin "Ajo s'po flet me kërkond". Po kur afrohem unë, ajo m'sheh kështu dhe ndoshta ftyrë ma e re m'ofrohet.

"Për çka je?" "Për politikë, m'kanë pru për politikë". I them, "A ke një letër, ni aktakuzë ni diçka?" Ma jep nër' derë. E marrë e shoh atë aktakuzë të saj. Aty kom pa mandej emra shokë t'mi që i njëfsha që kishin qenë t'listun te aktakuza dhe që e mora vesh se po mbahen. Ajo ka qenë pika e dytë orientuese, nifar' mënyre që m'ka bo me ditë ose m'ka ndihmu ma mirë me thanë qysh me u sjellë në kuptimin gjatë kohës sa jom marrë në pyetje. Këto dy momente kanë qenë goxha delikate dhe që nifar' mënyre nëse muj me thanë ma kanë lehtësu deri dikund përceptimin për ata se çka po ndodhë jashtë.

Në shkurt nashta, jo në shkurt edhe mars ka mujt me qenë, nuk muj me ditë me kohë. Kemi pasë vizita të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar që nifar' mënyre e kemi ditë që s'paku dikush jashtë po, po e din që ne jemi brenda dhe po mbahemi dhe qysh po trajtohem edhe krejt këtë pjesën tjetër. Moment i veçantë ka qenë gjithashtu edhe momenti kur te gjyqtarja hetuese m'kanë pytë për avokat mbrojtës. Ishte rregulli me t'pytë. E kom kërkun Lirien, Lirie Osmani, t'cilën duhet me ndoshta edhe këtu me falënderu për krejt përkushtimin që ka pasë në kohën kur ajo m'ka mbrojtë.

Unë kom qenë e vetëdijshme që avokat aso kohe kanë pasë ndoshta rol shumë të vogël për mos me thanë fare. Sepse nuk është se... ata thjeshtë janë marrë për shkak të procedurës. Po sjellja e saj njerëzore dhe mënyra qysh ajo e ka mirëkuptu ndoshta karakterin tem... unë n'fillim kur ka ardhë i kom thanë, "Thjeshtë t'kom thirrë me ju kallxu familjes se jom gjallë", tre ditë e para s'e kanë ditë a jam ose ku jam. "Mirëpo ma tutje", i kom thanë, "t'lutem mos thuj as t'nxjerrë as t'shpëtoj as kurgjo sepse unë e di që s'osht' n'dorën tande kurgjo dhe unë e ti mujna me folë për çka dush tjetër por jo për burgun edhe për çka jom këtu". Kështu ka përfundu.

Domethanë edhe mënyra qysh ajo s'ka përtu me ardhë me shpenzimet e veta, pa pagesë. Jo secili avokat ka qenë pa pagesë edhe n'atë kohë domethanë. Po Liria ka qenë e veçantë në këtë pjesë. Po du me shfrytëzu rastin me falenderu sepse me sa, me sa kom dëgju ajo edhe para meje... këtë informatë unë e kisha marrë prej grave n'burg që ajo kishte mbrojtë edhe ni ish tjetër t'burgosur politike para meje gjithashtu pa pagesë n'atë periudhë. E s'ka qenë shumë e lehtë as për të, besoj as financiarisht përveç rrezeve tjera që ka mujtë m'i sjellë për veti edhe për familjen.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Si ka qenë burgu? Kushtet sigurisht kanë qenë të tmerrshme po si keni jetu aty brenda?

Majlinda Sinani Lulaj: Dëgjo, llojet e... nëpër periudha të caktune burgjet kanë qenë ndryshe ndryshe. Në periudhën kur ne jemi arrestu Lipjani, objekti ku janë mbajtur gratë e ka pasë ni përparësi nëse muj me thanë, se ka qenë objekt i ndërtun ma vonë. Domethanë objekt ma i ri, ndërtesë ma e re. E fakti që ka qenë ndërtesë ma e re s'paku nuk e ka pasë atë pjesën ndoshta të lagështisë e do gjanave që pjesët e tjera të burgut ku kanë qenë meshkujt e kanë pasë, në këtë kuptim.

Pjesa tjetër pastaj edhe fakti që... ndëgjo, pjesa e burgut ti ambientohesh, mësohesh se nuk është se ishte Kosova e lirë e ti e ndishe lirinë jashtë. Ai ishte ni lloj burgu ma i vogël po pak a shumë ai lloj trajtimi. Natyrisht që nuk ka qenë e lehtë se presioni... për shembull, ni detaj të vogël, vazhdueshëm gjatë kohës sa banin kontrolla në dhoma të burgut çka ka, domethanë, gjana mjete të rrezikshme. Bile edhe ditën kur pranoresh aty të hiqen lidhësat, të hiqen çka ke varëse e vath. Çkado e vogël metalike që shërben, tash edhe prej punës që boj tash, e di që bohen me demek me siguru të burgosurin.

Mirëpo gjatë gjithë kohës... unë e kom pasë shtratin poshtë dhe kanë qenë shtratit dyshe. Vazhdueshëm në shtratin sipër, e s'ishte që s'bënin kontrolla. Bonin kontrolla dhe kanë mujtë me gjetë. Kishte ni thikë dhe ni zhiletë. Ato ishin si të thush zgjidhja ma e lehtë për ty që merresh në pyetje për çdo natë ose edhe për çdo ditë. Ka rregull gjithashtu me t'vu ato pak minuta, ni orë ishte rregulli paradite, ni orë masdite me t'vu në shëtitore. Po unë gjatë asaj periudhe shumë pak minuta edhe ditë t'caktune m'kanë lanë me dalë në shëtitore. Edhe në atë periudhë vishin me më marrë në pyetje.

Darkën shpesh herë, darkë nëse muj m'i thanë darkë, ishte ujë, ujë çka me thanë, ujë me mish pule. As s'kishte supë asni gja n'ta, thjeshtë ndonjë copë lëkure që sillej aty. Po edhe atë nuk m'linin në darkë me hangër. Ai presioni i vazhdueshëm dhe si të thush kur përfundonte marrja ne pyetje, kthimi pastaj në dhomë ishte ai procesimi i asaj çka kom thanë me mbajtë mend që të nesërmen me nejtë afër asaj deklaratës që kisha dhanë. Mos me u shmang prej asaj që kisha thanë. Ishte mënyra që ndoshta na i kishim diskutu sa ishim jashtë për metodat qysh mirresh në pyetje edhe për mënyrat.

Ka pasë ni libër aso kohe e pat' nxjerrë nëse s'gaboje për torturat në burg, Burgun e Gjilanit ose diçka e tillë. E që shpesh i kishim diskutu ose i kishim lexu kështu msheftas me ditë çka bohet. Ti veç mujshe me marrë me mend çka munet me ndodhë. Kaniherë edhe ky presioni ishte i mjaftueshëm domethanë me kriju presionin për mënyrën qysh ti e bon jetën aty brenda. Megjithatë edhe ajo periudhë domethanë... mandej erdhi puna e gjykimit që ka qenë krejt, si të thush, e veçantë në mënyrën qysh na ka trajtu. Sepse na nuk kishim, nuk dërgoheshim një nga një.

Na kemi qenë persona që na bartnin me autobus me durë lidhuna mbrapa shpinës. Qysh ka qenë edhe te mjeku kur t'çojshin aty brenda i kishe dy gardiene afër edhe durë mbrapa shpinës prapë. Kjo e lidhshin me aktakuzën me nivelin me demek të rëndësishme së aktakuzës, a çka di unë. Edhe këtu kur na sillshin domethanë mënyra qysh na futshin në gjykatë ka qenë e atillë që me kriju frikën edhe panikën te njerëzit. Nuk ishte e rastësishme, ata mundeshin me na çu edhe qetë se na me durë lidhë ishim. Po domethanë, bohej në mënyrë spektakulare thjeshtë për me kriju qat' frikë te njerëzit.

Mendoj që pat' ardhë në moment kur kjo frikë u tejkalu. Sepse e kujtojsh në moment... unë e përmenda në moment në '93-ten në kohën kur janë dënu njerëzit e LPK-së dhe LKQK-së dhe në atë periudhë sa është mbajtur gjykimi kemi qenë me dy Hyra, Hyrë Emini dhe Hyrie Velu edhe unë. Kemi dalë vazhdueshëm me familjarët përballë gjykatës dhe Naiti kohë pas kohe në atë kohë. E kujtoj që në atë kohë përveç familjarëve askërkush nuk dilte përpara gjykatës në kohën kur i sillnin dhe kur i nxirrnin prej sallës të gjyqit, as kërkush. Ata familjar edhe ata nga një për familje.

Ndërkaq në kohën kur erdhëm na, në kohën kur ne po gjykohehim e mbaj mend që ishte plot pjesa përpara gjykatës. Jo thjeshtë familjar besoj. Kishte shoqni, kishte njerëz. Domethanë sikur ish, kish fillu me ndrru diçka mrena reagimit të qytetarëve në këtë vend. Mendoj që kjo ka qenë mandej sinjal që ka ardhë koha noshta me masivizu dhe me ndrru, si me thanë, çasjen kolektive si përgjigje kundër në regjimi që e ka...

Anita Susuri: Sa u dënuat ju?

Majlinda Sinani Lulaj: Jemi dënu me radhë. Unë jam dënu me dy vjet neni 116 nëse s'gabo, alinea një mandej e lidhun me në nën tjetër ose diçka e tillë. Prej t'cilave nëntë prej nesh, se na kemi qenë grup domethanë jemi dënu me grup 20 persona. Dy në mungesë. Nëntë prej nesh jemi dënu nën pesë vjet. Kjo nuk ka qenë kur na kanë lëshu nuk ka qenë lirim. Na nuk jemi liru. Na jemi lëshu deri në plotfuqishmëri të aktvendimit në shkallën e dytë. Kështu ka thanë ligji kështu kanë, e kanë zbatu.

Qiky moment domethanë na jemi liru nëntë që kemi qenë t'dënu për herë t'parë është fjala. Për herë t'parë nën pesë vjet t'ka liru deri në plotfuqishmëri të vendimit në shkallën e dytë. Mirëpo derisa ka ardhë ajo... tash edhe këtu është në moment që nashta ia vlen me përmend. Jemi liru në maj, me 30 maj domethanë ka përfundu gjykimi dhe na jemi liru të tjerët janë... në fakt fillimisht na kanë kthyer nëpër dhoma të burgut po ma vonë na tërhoqën edhe na lirin.

Këtu fillon ajo periudha domethanë kur unë kthehem në shpi. Kishte vizita prapë edhe ky dallimi me të kalunën. Unë e kam edhe burrin në ish të burgosur politik po ai e tregon periudhën kur ai është liru në '89-ten kur njerëzit edhe n'rrugë kanë pasë frikë me i thanë a je si je ose shqyr që ke dalë. Mirëpo në kohën kur unë jam liru, përmbi tre mijë njerëz kanë hy e kanë dalë në familje. Domethanë ka pasë në tjetër reagim të popullatës, në heqje frike, në lloj solidariteti që ka ndryshu edhe prej periudhës sa kemi punu na.

Kryhet kjo periudhë, fillon me 01 tetor ishte protesta e studentëve. Kam ardhë në protestë se s'durohesha (qeshë). Edhe pse kishte mendime prej shokve që nashta është mirë... se nëse zihesh shkojsha direkt në vujtje të dënimit po kush me na ndalë atëherë. Me 6 tetor kom mbrojtë temën e diplomës. Se e kisha, thashë, edhe n'janar domethanë e kisha t'u e përgadit po aty e kom përmbyllë. Kishte edhe një protestë tjetër të vogël me fleta t'bardha i kemi pasë thanë. Kemi qenë këtu. Nuk e kujtoj shumë në detaje domethanë se ka qenë periudhë shumë intensive. Bile këtu dikund kemi qenë, te kjo pjesa këtu afër te zyret e juja, te ky udhëkryqi këtu.

E kujtoj aty shoktë na, si me thanë, u ndam me shoktë ni vajzë, ni djalë në mënyrë që në rast veç se tentojnë me na arrestu ose diçka me qenë dikush pak ma i fuqishëm që mundet me na tërheqë. Ajo ka qenë, si të thush, protesta... e kom nisë me protesta fakultetin edhe e kom përmbyllë me protesta dhe këtu është mbyllë kjo pjesë. Pastaj në pritje të kësaj vendimi të plotfuqishëm të shkallës së dytë natyrisht që në momentin kur kanë fillu me na ardhë sinjalet që janë t'u u shpërnda aktvendime të kësaj natyre kom kërkim mundësi që me u... unë veç vuna kurorë ndërkohë, u martova dhe isha në kërkim si të thush ni rrugë zgjidhje se për të dytën herë e gjallë s'ju bija n'dorë.

Domethanë ishte moment që nëse në herën e parë e kishim qëndrimin që jo me dalë jashtë po këtu me qëndru edhe me u përballë me realitetin edhe me thanë që po e bajmë dhe jemi t'u e bo sepse kjo është rruga që kjo na takon si komb edhe si vend. Në anën tjetër vjen ni moment tjetër kur përkundër krejt kësaj e gjallë prap në dorë nuk e marrsha me mend me ra. Në janar të '98-tes gjendet një mundësi, për shkak se kërkush ilegalisht nuk ka pranë me më transportu, domethanë në autobus s'kom mujtë me dalë. Në aeroplan domethanë asni shans nuk ishte.

Dal... vjen n'fakt, nëpërmjet Sali Lajçit takohet ose kontaktohet ni Ali Dakaj, osht' edhe sot diku. I cili vjen edhe na bohet, si të thush, pika e kontaktit kur jemi nisë prej Pejës për në Mal të Zi. Në ni vend kufitar kemi shku deri në Tivar. Në Tivar ka dalë na ka marrë ni Muhamet Kurti t'cilit ia kom borxh jetën ndoshta. I cili ka ardhë na ka tërheq me veturë na ka mbajtur n'shpinë e vet atë natë. E kujtoj që kur kemi, kur kemi nejtë atë natë n'mramje në familjen e tij... se na ishim nisë për Shqipni, domethanë me dalë nëpërmjet Malit të Zi nëpër cilitdo kanal që funksiononte edhe me dalë në Shqipni.

E kujtoj ishte, ishte periudha fill pas '97-tes. Ndoshta ni diçka, ni detaj i vogël, kur në Shqipni kishte ndodhë '97-ta me ato çka kishte ndodhë... që na që kemi qenë mbyllë nuk i dijmë krejt detajet. Ka pasë ni, e kujtoj kur vinin me më marrë në pyetje, ni lloj ekzaltimi të inspektorëve të sigurimit për çka po ndodhë në Shqipni. Thjeshtë e di prej fjalëve të tyre e kuptojsha që diçka osht' t'u ndodhë në Shqipni. Po nuk majshe me ditë çka as qysh. Kur kemi shku te ky burri, ky Muhamet Kurti, ky m'thotë mu, "Mos insisto me dalë në Shqipni", thotë, "se osht' shumë keq situata. Gjej ni mundësi tjetër me dalë në Kroaci edhe me u tërheq në Europë".

E gjej vetën me ni moment kur i kom thanë... “Se osht’ keq”, m’thotë. Edhe i thom, “Unë i mbyll sytë ku të shoh keq”, dhe prap insistoj me dalë. Kemi dalë të nesërmen në mëngjes nëpërmjet një bune të fryme me ni bark gjysa ujë gjysa ashtu. Nja 40 minuta deri në Muriqan. Prej Muriqan në Shkodër, prej Shkodër në Tiranë. Ky zotniu as nuk na mor’ pagesë as asni gja që na ndihmojë se ku kishim me i marrë t’shkretat, aso kohe.

Është interesant me përmend që kur kemi mrrri në Tiranë, unë isha drejtu në atë kohë në Tiranë m’jetonte kjo shoqja Hyri Emini e cila ishte tërhekë për shkak të përndjekjes së vëllezërve dhe të aktivitetit që ata e kishin, ishin tërhekë në Tiranë. Kishin shitë shpinë në Ferizaj dhe jetonin atje. Unë atë e kisha adresë në Tiranë se s’kisha ku me shku. Isha bashkë me burrin. Takohemi në Tiranë me njerëzit e parë që jemi taku, para se të takohemi me bacën Dan të ndjerin, vllaun e Hyrës. Takohemi me Ramiz Lladrovcin edhe me ni djalë që ishte me të.

Kemi ndërru bisedë. M’thotë, “M’vjen mirë që ke dalë prej durve ku ke qenë”, se e kishte marrë vesh që kemi qenë n’burg. “Ku keni me shku?” I tregoj, e njipte si familje. Në momentin kur dojmë me u nda me të i kthehem ktij djalit që ishte me të edhe i them... se nuk ma thanë emrin, nuk e dita kush osht’ ai. I them, “Nuk e di kush je as nuk e di për ku je nisë”, se ishte me Ramizin bashkë, them, “po gjatë kohës sa kam qenë brenda m’kanë pytë për dikë që t’përngjan shumë ty, veç ma i vjetër se ti. Pak ma i vjetër se ti. T’lutna nëse je nisë për Kosovë”, unë s’e kisha idenë për ku është nisë ai djalë me Ramizin. “Po nëse je nisë për Kosovë mos shko sepse ti shpërndan, identik je me atë”.

Ma vonë e kom kuptu që ai ka qenë Luli i Adem Jasharit. Po gjatë kohës kur jemi marrë n’pyetje, domethanë, në fotografitë që na... unë s’e kom njoftë, nuk e kom taku ndonjëherë. Po fakti që m’kishin pytë për të... ajo lythi, floktë, domethanë, komplet konstrukti. Shpesh herë kur e kom përshkru me dikë prej shokve m’kanë thanë, “Mos t’kanë pytë për Fehmiun?” Se t’u qenë unë e Drenasit, “Mos kanë pytë për Fehmi Lladrovcin?” Po konstrukti i Fehmiut ishte ftyra ma e gjatë ndërkaq te Ademi ishte ma rrumbullakët. Ky ishte identik ftyra veç ma i ri. Buzëqeshi se e ka ditë historinë edhe jetën e familjes t’vet po unë s’e kisha idenë.

I them, “T’lutem nëse je nisë për Kosovë mos u kthe”. Aty jemi nda. Me Ramizin pastaj kemi pasë rast m’u taku edhe dy-tri herë tjera. Aty fillon pjesa e ni jete tjetër mandej në Shqipni. Fillimisht me protesta edhe atje dhe me demonstrata për shkak të ngjarjeve të marsit që ndodhën kënde. Mirëpo në kohën kur veç e mendojshim me u rikthy se u pan sinjalet që po don me u ba luftë, unë u sëmura me veshka, isha shtatzanë dhe vazhdoj me ndejtë në Shqipni deri në mars ‘99 kur kanë fillu bombardimet e NATO-s. Me dy-tre tentativa me dalë e që kthehesha domethanë dhe në mars ‘99 mbrij me dalë nëpërmjet Italisë në Zvicërr. Prej ku kthehem në 2000 në verën e vitit 2000 bashkë me vajzën edhe me burrin.

Anita Susuri: Gjatë luftës a keni pasë kontakt me familje? A ka qenë vështirë?

Majlinda Sinani Lulaj: Shumë pak. Pjesën e fundit për shembull këtë pjesën prej bombardimeve të NATO-s e mandej depërtimi i tyre në Maqedoni... se unë komplet familjen i kemi pasë këtu edhe unë edhe burri. Shumë rrallë me të thanë të drejtën, katër-pesë herë ndoshta. Thashë, familja ime as s'kanë pasë telefon në banesë po nuk është se kanë nejtë gjithmonë aty. Ni periudhë të luftës nana me... domethanë kanë qenë të shpërndan. Nana me dy fëmijë e vegjël kanë qenë në Bjeshkët e Berishës ni kohë. I kanë zanë ato ofensivat e asaj periudhe. Domethanë kështu kanë qenë të shpërndan. Motra diku tjetër, vëllau i dytë diku tjetër.

Mandej vjen ni moment kah janari i '99 diku n'bazë të asaj që m'kanë përshkru që rikthehen në Drenas. T'u mendu që u qetësu rikthehen në apartament. Aty mandej ju digjet shtëpia. Fatmirësisht ata shpëtojnë, shkojnë në shtëpinë e tezës po edhe prej aty i nxjerrin, i kryjnë ato t'vetat domethanë rrahje çka ka pasë. I ngarkojnë në... në atë periudhë vëllau im ka punu, në periudhën kur ka qenë OSBE ktu m'ka punu si përkthyes për OSBE. Që ishte rrezik i dyfishtë mandej për me u arrestu ose diçka e tillë. Po që n'fund i ngarkojnë nëpër këto autobusët kur i kanë depërtu në, diku në maj mendoj, kur i kanë depërtu në shtet të Maqedonisë.

E di që kanë qenë në kamp edhe prej aty mandej në Angli. Ka marrë Anglia 200 familje komplet shqiptare dhe qe qashtu kanë mbetë atje. Pas luftës pastaj t'u e përfshi edhe qit' periudhën që unë kom dalë ma herët për nja tetë vjet nuk i kom taku, as nuk i kom pa. Sepse ata nuk kanë pasë ni dokument udhëtimi për me ardhë këndej edhe unë nuk kom pasë mundësi me shku atje. I kom taku tek mbasi jom bo nanë me dy fëmijë. Sa i bjen? Domethanë në 2006-ten prej '98-tes.

Anita Susuri: Qysh ka qenë ai kthimi në Kosovë pas kaq viteve?

Majlinda Sinani Lulaj: Jo. Unë jom kthy në verën e 2000-tes në fakt. Unë jom kthy edhe e kom gjetë Kosovën me atë shkrumin e luftës që thuhet, me vështirësitë e njerëzve. E kom përjetu atë periudhën e mbas luftës. Jo e lehtë. Na ishim djegë e pjekë, si të thush, në të dy antë. Edhe te familja e prindërve të mi edhe te familja e burrit, nuk është se kishim ku me ndejtë. Unë ni periudhë kom ndejtë në Pejë në ni shtëpi të cilën e kishin ble kusheri të burrit tem të cilët kishin jetu jashtë. Për katër vjet aty.

Mandej kom ardhë në Prishtinë dhe kom fillu fillimisht me qera dhe kështu me radhë e kom ndërtu jetën dhe kam ndërtu ndoshta, nëse muj me thanë, edhe aspektin profesional të jetës të jetës tem. Nuk ka qenë e lehtë. Ka pasë periudha edhe zhgënjimi edhe ndoshta pse kemi mbetë, jemi disa që kemi mbetë idealista prej atëherë. Kemi mendu që shumë çka mundet me qenë edhe me u ndërtu ndoshta simbas andrrave tona po jo gjithçka osht' qaq e thjeshtë. Jeta edhe zhvillimet janë ma komplekse sesa andrrat ndoshta që i kemi pasë.

Kur nalësh e mendon, nuk ka krahasim mes asaj periudhe dhe kësaj periudhe natyrisht. Nuk... krahasim nuk mund të vihet. Po thjeshtë mirë edhe ma mirë, a thu kemi mujtë me ba ma mirë? A thu kemi mujtë secili prej nesh me ofru ma shumë? A thu çka osht' dashtë me ba ndryshe ndoshta? Me i

pasë ndoshta do probleme që sot janë aktuale me qenë t'zgjedhuna. Po n'këtë drejtim natyrisht që mbetet punë m'u bo. Ndoshta edhe prej nesh që nashta s'ka përfundu misioni hala.

Anita Susuri: Ju faleminderit shumë zonja Majlindë, ishte knaqësi!

Majlinda Sinani Lulaj: Faleminderit juve për mundësinë!